

NDIKIMI I RETORIKËS SË LIDERISHIPIT POPULIST NË EROZIONIN E BESIMIT NDAJ PROCESHEVE DEMOKRATIKE

Klajdi Logu

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në
Shkenca Sociale dhe të sjelljes, me profil Sociologji Politike
për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Dr. Tonin Gjuraj

Numri i fjalëve: 51.858

Tiranë, Maj, 2025

DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë, Klajdi Logu, deklaroj se disertacioni me titullin “Ndikimi i retorikës së lidershipit populist në erozionin e besimit ndaj proceseve demokratike” është një punim origjinal i përgatitur nga unë. Të gjitha burimet, idetë dhe të dhënat e përdorura janë cituar me saktësi sipas standardeve akademike të Universitetit European të Tiranës.

ABSTRAKTI

Ky punim shqyrton ndikimin e retorikës së lidërshiptit populist në erozionin e besimit ndaj proceseve demokratike, duke analizuar mekanizmat përmes të cilëve retorika populiste ndikon në opinionin publik dhe stabilitetin institucional. Qëllimi i punimit është të nxjerrë në pah tiparet e kësaj retorike, që përdor antagonizmin mes "popullit" dhe "elitës," thirrjet emocionale dhe polarizimin, të cilat mundësojnë mobilizimin e mbështetjes dhe minimin e besimit ndaj institucioneve tradicionale demokratike.

Studimi përdor një metodologji të kombinuar, që përfshin si qasjet dhe analizat sasiore ashtu edhe qasje cilësore. Është realizuar një analizë përmbajtësore e fjalimeve të liderëve populistë, veçanërisht e politikanëve si Viktor Orbán dhe Donald Trump. Përveç kësaj, intervistat gjysmë të strukturuar me pjesëmarrësit ndihmuan për të zbuluar sesi mesazhet populiste rezonojnë me përvojat individuale, duke forcuar ndjenjat e zhgënjimit dhe mosbesimit ndaj institucioneve demokratike.

Gjetjet kryesore treguan se retorika populiste ka një ndikim të veçantë emocional mbi grupet sociale me nivele të ulëta besimi ndaj sistemit ekzistues, veçanërisht midis segmenteve të popullsisë që janë më pak të arsimuara dhe ekonomikisht të prekshme. U konstatua se këto grupe kanë më shumë gjasa të pranojnë konceptet politike të thjeshta dhe binare të ofruara nga liderët populistë. Studimi konfirmoi se retorika populiste thellon polarizimin shoqëror dhe kontribuon në rritjen e mosbesimit ndaj institucioneve demokratike, veçanërisht ndaj gjyqësorit, medias dhe sundimit të ligjit.

Rezultatet e studimit gjithashtu treguan ndikimin negativ të polarizimit, i cili përkeqësohet nga retorika populiste, mbi stabilitetin demokratik, kur votuesit fillojnë të perceptojnë institucionet politike jo si një pjesë integrale e demokracisë, por si pengesa për realizimin e "vullnetit të vërtetë" të popullit. Duke marrë shembuj nga vende si SHBA, Hungaria, Shqipëria, Brazili, Filipinet, Franca, Spanja dhe Italia, u analizua sesi temat e veçanta, si lufta kundër korrupsionit, retorika e identitetit kombëtar dhe thirrjet emocionale, ndikojnë në opinionin publik dhe gatishmërinë për të mbështetur masa autoritare.

Bazuar në të dhënat e marra, u arrit në përfundimin se përdorimi i retorikës populiste dobëson besimin e qytetarëve ndaj institucioneve demokratike dhe kontribuon në degradimin e tyre gradual, çka përbën një rrezik për stabilitetin afatgjatë të sistemeve demokratike.

DEDIKIMI

Ky punim i dedikohet familjes time, për dashurinë, mbështetjen dhe frymëzimin e pakushtëzuar.

FALENDERIME

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë dhe përrulje ndaj udhëheqësit tim, Prof. Dr. Tonin Gjuraj, i cili më ka udhëhequr me përkushtim, ekspertizë dhe dashuri gjatë këtij rrugëtimi akademik. Falënderoj gjithashtu kolegët e departamentit të Shkencave Sociale të Aplikuara, me të cilët kam ndarë përvojë, eksperiencë dhe një mirëkuptim të thellë që më kanë ndihmuar të rritem profesionalisht dhe personalisht. Për më tepër, shpreh falënderimet e mia të singerta Universitetit European të Tiranës, i cili më ka ofruar mundësinë, besimin dhe mbështetjen e vazhdueshme, duke qenë motori i vërtetë që më ka inkurajuar të ec përpara në këtë rrugë kërkimore.

Tabela e permbajtjes

Kapitulli 1. Hyrje	01
Kapitulli 2. Rishikim Literature	06
Operacionalizimi i Populizmit	07
Varietetet e Populizmit	12
Retorika Populiste: Konceptualizimi dhe Aplikimi	16
Qasjet kryesore për të vështruar populizmin si strategji politike.....	20
Kapitulli 3. Metodologjia	25
Modeli i Hulumtimit	26
Perzgjedhja e vendeve dhe lidereve politike për analizë.....	27
Metodat e Mbledhjes së të Dhënave	28
Pjesëmarrësit	28
Analiza e Përmbajtjes	33
Teknikat e Analizës së të Dhënave	34
Triangulimi i të Dhënave	36
Kapitulli 4.Rezultate.....	37
Analiza e Retorikës Populiste në Fjalimet Politike	43
Influenca e retorikës populiste në sistemet/institucionet demokratike.....	52
Ndjeshmëria e Segmenteve Sociale ndaj Retorikës Populiste	67
Pasojat e Retorikës Populiste në Stabilitetin Demokratik	81
Kapitulli 5. Diskutime	88
Kufizimet e Studimit	103
Kapitulli 6. Konkluzione	105
Bibliografia.....	111
Shtojca	123
Pyetjet e Anketës	123
Transkripti i Intervistave	127

Lista e tabelave

Table 1.	31
Table 2.	38
Table 3.	39
Table 4.	43
Table 5.	45
Table 6.	76

Lista e figurave

Figure 1.	39
Figure 2.	40
Figure 3.	47
Figure 5.	48
Figure 6.	49
Figure 7.	52
Figure 8.	53
Figure 9.	54
Figure 10.	55
Figure 11.	56
Figure 12.	59
Figure 13.	60
Figure 14.	61
Figure 15.	62
Figure 16.	68
Figure 17.	68
Figure 18.	71
Figure 19.	75

Kapitulli 1. Hyrje

Gjatë 10 viteve të fundit, lëvizjet populiste janë bërë një pjesë integrale e peizazhit politik në shumë vende demokratike. Populizmi, i cili fillimisht konsiderohej si një fenomen i forcave marginale politike, tani është shndërruar në një mjet të fuqishëm për të ndikuar te votuesit, veçanërisht në kontekstin e krizave dhe sfidave socio-ekonomike (Berman, S. 2021). Liderët populistë shfrytëzojnë pakënaqësinë publike për të mobilizuar masat, duke u paraqitur si përfaqësuesit e vetëm të vërtetë të "popullit" dhe duke u pozicionuar kundër elitës politike, të cilën ata e fajësojnë për rënien dhe dështimin e institucioneve shtetërore. Fjalimet e tyre bazohen zakonisht në idenë se vetëm ata mund t'ia kthejnë pushtetin popullit dhe të rikthejnë drejtësinë në shoqëri (Cassell, K. J. 2023).

Retorika populiste ka disa karakteristika që e bëjnë jashtëzakonisht tërheqëse për një gamë të gjerë qytetarësh. Një nga veçoritë kyçe është postulimi i një përplasjeje të thellë midis "establishmentit" dhe "popullit" (Casiraghi, M. C. 2021). Në diskursin populist, elita përshkruhet si e korruptuar dhe indiferente ndaj interesave të njerëzve të zakonshëm. Populistët krijojnë një dikotomi të qartë ku "populli" përfaqëson burimin e vlerave të vërteta dhe drejtësisë, ndërsa elita shihet si armik që vepron vetëm për interesat e veta dhe shtyp nevojat reale të qytetarëve. Në këtë kontekst, populistët e pozicionojnë veten si përfaqësuesit e vetëm të popullit, të aftë për t'i mbrojtur ata nga qëllimet e këqija të elitës (Borah, A., Singh, S. R. 2022). Një strategji e tillë u lejon liderëve populistë të formojnë një mbështetje të fortë emocionale nga ata që ndihen të zhgënjyer dhe të pakënaqur me sistemin ekzistues.

Komponenti emocionale luan një rol të rëndësishëm në retorikën populiste. Fjalimet e populistëve janë të mbushura me emocione dhe apelojnë fuqishëm ndaj ndjenjave të frikës, zemërimit, indignatës ose shpresës. Emocionet lejojnë një mobilizim të shpejtë të mbështetjes masive, pasi perceptimi emocional shpesh mbizotëron mbi analizën racionale. Njerëzit e përfshirë në një valë emocionale priren të veprojnë më vendosmërisht, duke mbështetur liderë që u japin shpresë për një zgjidhje të shpejtë të problemeve ose premtojnë të luftojnë kundër atyre që supozohet të jenë përgjegjës për vështirësitë e tyre (Beauregard, P. 2022). Emocionaliteti i retorikës bëhet një mjet i fuqishëm për forcimin e lidhjes me audiencën, duke e bërë atë të ndiejë se interesat e saj mbrohen nga një lider që e kupton dhe e mbështet. Përveç emocionalitetit të tepruar, retorika populiste karakterizohet edhe nga thjeshtësia. Përballë sfidave socio-ekonomike, populistët ofrojnë shpjegime të thjeshta dhe intuitive për problemet dhe zgjidhje të lehta. Është një qasje maksimaliste bardh-e-zi ndaj realiteteve komplekse sociale apo politike, ku ekzistojnë vetëm fajtorët dhe viktimat, pa marrë parasysh thellësinë dhe shumëdimensionet e problemeve reale (McCall-Smith, K., et al. 2020).

Thjeshtësimi i tepërt u mundëson populistëve të krijojnë mesazhe të qarta, të cilat masat i përvetësojnë shpejt, duke siguruar kështu mbështetje të gjerë.

Ky stil retorike ndihmon liderët populistë të rrisin mbështetjen, veçanërisht mes popullsisë që ndihen të marginalizuara socialisht ose ekonomikisht. Megjithatë, pavarësisht nga këto manifestime të aktivizmit demokratik, populizmi shpesh paraqet një kërcënim për vetë themelet e demokracisë liberale. Një nga sfidat më të mëdha që i sjell institucioneve demokratike është se populistët, pasi marrin pushtetin, rrallëherë përpiqen ta ndajnë atë ose të promovojnë vendimmarrjen përfshirëse (Sager, T. 2020). Përkundrazi, ata priren të forcojnë pushtetin e tyre personal, të kufizojnë institucionet e pavarura dhe të minojnë parimet e shtetit të së drejtës.

Kjo temë merr një rëndësi të veçantë në mesin e debatit në rritje mbi të ardhmen e demokracisë në një botë gjithnjë e më të polarizuar. Polarizimi, i cili po bëhet gjithnjë e më i theksuar në shumë shoqëri, është si shkak ashtu edhe pasojë e përhapjes së populizmit. Vala aktuale e populizmit dallon për faktin se nuk synon një refuzim të drejtpërdrejtë të demokracisë si koncept, por përpiqet të transformojë sistemet demokratike në mënyrë që të jenë më në përputhje me interesat e liderëve populistë. Kjo përfshin minimin e themeleve bazë të demokracisë liberale, si pavarësia e gjyqësorit, liria e shtypit dhe të drejtat e pakicave.

Retorika populiste shfrytëzon ndarjet ekzistuese në shoqëri dhe thellon mosbesimin ndaj institucioneve demokratike. Ajo bazohet në idenë se sistemet demokratike nuk janë në gjendje të përfaqësojnë në mënyrë efektive popullin, ndaj këto sisteme ose duhet të reformohen në mënyrë radikale, ose edhe të shkatërrohen për të rikthyer “demokracinë e vërtetë”. Si rezultat, polarizimi shoqëror po përkeqësohet, duke e komplikuar më tej procesin e rikthimit të besimit në institucionet demokratike, pasi grupet e ndryshme të popullsisë fillojnë t’i shohin njëra-tjetrën si armiq dhe vendimet politike si një betejë për pushtet, jo si një kërkim për kompromis.

Si në Evropë, ashtu edhe në Amerikën e Veriut, po ndodh një rikonceptim populist i diskursit demokratik. Formula binare e “elitës së korruptuar” dhe “njerëzve të zakonshëm”, e kombinuar me retorikë të mbushur me emocione, ka shkaktuar zhgënjim mes elektoratit dhe ka minuar besimin në institucionet demokratike. Ky erozion i besimit në proceset demokratike është një nga pasojat më fatale të retorikës populiste.

Populizmi konsiderohet si një “ideologji e fshehtë”, që do të thotë se mund të ndërthuret me rryma të tjera ideologjike, si të majta ashtu edhe të djathta, në varësi të kontekstit (Mastropaolo, A. 2023). Strategjia retorike e kundërvënies mes popullit dhe elitës realizon një sërë manipulimesh psikologjike, si krijimi i ndjenjës së përkatësisë dhe përfshirjes mes mbështetësve, duke dënuar njëkohësisht kundërshtarët politikë, përmes një gjuhe të ngarkuar emocionale që shton ndarjet në shoqëri (Rhodes-Purdy, M., et al. 2021).

Efektiviteti i retorikës populiste qëndron në aftësinë e saj për t'u lidhur me përvojat dhe pakënaqësitë e përditshme të njerëzve të zakonshëm. Liderë si Donald Trump në Shtetet e Bashkuara dhe Viktor Orbán në Hungari kanë përdorur mjeshtërisht gjuhën populiste, e cila ngjall ndjenjën e viktimizimit mes mbështetësve të tyre. Narrativa e Trump-it përfshin pretendime se "elitët" kanë manipuluar sistemin kundër punëtorëve të "harruar" amerikanë, duke krijuar një mjedis ku individët ndihen të justifikuar për pakënaqësitë dhe shqetësimet e tyre. Në mënyrë të ngjashme, Orbán paraqet peizazhin politik të Hungarisë si një luftë kundër ndikimeve të huaja dhe elitave vendase, duke e pozicionuar veten si mbrojtës të identitetit kombëtar dhe sovranitetit (Neerdaels, J., et al. 2024).

Duke e portretizuar elitën politike si armikun e popullit, retorika populiste krijon një atmosferë dyshimi ndaj strukturave tradicionale demokratike, duke përfshirë partitë politike, median dhe gjyqësorin (Just, M., Crigler, A. 2020). Me kalimin e kohës, kjo mund të minojë besimin publik në këto institucione, duke sjellë një cikël zhgënjimi dhe distancimi nga procesi demokratik. Besimi në institucionet demokratike është thelbësor për funksionimin dhe stabilitetin e tyre. Megjithatë, rritja e populizmit shoqërohet me një ulje të dukshme të besimit publik në këto institucione. Kur liderët populistë e formësojnë retorikën e tyre si një konfrontim të drejtpërdrejtë me "establishment-in", ata inkurajojnë mbështetësit e tyre që t'i shohin këto institucione jo si komponentë të rëndësishme të demokracisë, por si pengesa ndaj përfaqësimit të vërtetë. Ky transformim është i dukshëm në vende të ndryshme ku lëvizjet populiste kanë fituar mbështetje. Përvoja e Amerikës dhe Kinës tregon një rritje të ndjeshme të skepticizmit publik ndaj medias dhe sistemit gjyqësor, të cilat paraqiten si mjete të elitës të projektuara për të shtypur zërin e popullit (Garland, D. 2021; Sprick, D. 2021; Blokker, P., Mazzoleni, O. 2020).

Pasojat e këtij rënieje të besimit janë të thella. Ndërsa besimi zvogëlohet, gatishmëria e qytetarëve për të marrë pjesë në proceset demokratike—si votimi, pjesëmarrja në aktivitete qytetare, apo mbështetja e normave demokratike—mund të reduktohet ndjeshëm. Fenomeni i "lodhjes demokratike" bëhet i dukshëm kur qytetarët ndihen të zhgënjyer nga sistemi politik dhe vënë në pikëpyetje aftësinë e tij për të përfaqësuar interesat e tyre (Neuteboom, S. 2021). Ky ndjenjë mund të krijojë një mjedis të përshtatshëm për retorikën e mëtejshme populiste, duke çuar në një cikël të dëmshëm që përkeqëson problemet fillestare me besimin dhe përfshirjen.

Një aspekt i retorikës populiste mbështetet në thirrjen për sakrificë, e cila luan një rol kyç në mobilizimin e mbështetjes dhe forcimin e ndarjes midis "popullit" dhe "elitës." Duke pozicionuar mbështetësit si viktimë të padrejtësive sociale, liderët populistë mund të mobilizojnë bazën e tyre dhe të forcojnë një ndjenjë identiteti kolektiv të bazuar në ankesat e përbashkëta. Në shembullin finlandez, një retorikë e tillë promovon mbështetjen për liderin duke i lehtësuar mbështetësit nga presioni për të marrë përgjegjësi për rrethanat e tyre (Rovamo, H., Sakki, I. 2024). Kjo strategji është veçanërisht efektive në një kontekst neoliberal ku individët janë bindur se suksesi është rezultat i arritjeve dhe

përpjekjeve personale. Kur liderët populistë ndryshojnë narrativën për të theksuar se mbështetësit e tyre janë viktimë të forcave të jashtme—si globalizimi apo elitat e korruptuara—ata lehtësojnë disa nga presionet psikologjike të lidhura me dështimin personal. Si rezultat, mbështetësit mund të bëhen më të prirur për të mbështetur liderë që u ofrojnë atyre një narrativë që i çliron nga përgjegjësia duke fajësuar elitat kundërshtare.

Kjo strategji e dyfishtë e zhvendosjes së fajit jo vetëm që forcon mbështetjen për liderët populistë, por gjithashtu ushqen një mosbesim më të madh ndaj institucioneve tradicionale demokratike. Kur njerëzit fillojnë të shohin veten si viktimë, ata bëhen më të prirur për të perceptuar institucionet si bashkëfajtores në viktimizimin e tyre, duke minuar më tej besimin. Retorika e viktimizimit kështu shërben për të forcuar narrativat populiste, duke krijuar një mjedis toksik për përfshirjen dhe bashkëpunimin demokratik.

Ndikimi emocional i retorikës populiste është veçanërisht i fuqishëm ndër grupet më pak të arsimuara ose ato me stabilitet social të dobët, të cilët janë të prirur për reagime të forta emocionale ndaj retorikës anti-elitare (Schumacher, G., et al. 2022). Kjo kategori votuesish tregon nivele të larta të emocioneve "të forta", si indinjata ose madje urrejtja, gjë që rrit më tej polarizimin social (Sakki, I., Martikainen, J. 2021). Këto grupe zakonisht kërkojnë mbrojtje nga një sistem politik që duket i pandjeshëm ndaj problemeve të tyre.

Liderët populistë shpesh i referohen "krizës së demokracisë", duke argumentuar se institucionet nuk punojnë për interesin e popullit, por mbrojnë vetëm interesat e elitave (Bartels, L. M. 2023). Një retorikë e tillë bën që disa qytetarë të fillojnë të konsiderojnë institucionet demokratike joefektive ose madje të korruptuara, duke minuar kështu legjitimitetin e demokracisë. Në disa raste, populistët mund të shkaktojnë dëme të qëndrueshme në institucionet demokratike nëse fitojnë ndikim të rëndësishëm politik. Si shembuj të populistëve që përdorin retorikë për të zhvendosur fajin për problemet ekonomike dhe sociale te elitat ose kërcënimet e jashtme, mund të përmendim liderë si Jair Bolsonaro në Brazil dhe Rodrigo Duterte në Filipine (Jenne, E. K., et al., 2021; Schumacher, G., et al. 2022).

Objektivi i kësaj disertacioni është zhvillimi i një modeli konceptual që ndriçon mekanizmat përmes të cilëve retorika e lidershit populist ndikon te besimi në proceset demokratike dhe dhënia përgjigjeje e pyetjes kërkimore se “Si ndikon retorika e lidershit populist në erozionin e besimit ndaj institucioneve demokratike?”. Duke u fokusuar te retorika e liderëve populistë, hulumtimi synon të analizojë elementet e këtij diskursi që kanë më shumë jehonë në grupe të caktuara sociale dhe të identifikojë implikimet më të gjera shoqërore të kësaj retorike. Qëllimet kryesore përfshijnë:

1. Ekzaminimin e komponentëve kryesorë të retorikës së lidershit populist dhe influencën e tyre për të mobilizuar mbështetje;
2. Analizën e dinamikës së rënies së besimit në proceset demokratike;

3. Identifikimin e grupeve kryesore sociale që janë veçanërisht të ndjeshme ndaj retorikës populiste.

Kontributi i kësaj disertacioni është i rëndësishëm për fushën, duke ofruar një analizë të nuancuar të mekanizmave përmes të cilëve retorika populiste ndikon te besimi në institucionet demokratike. Ndërsa një pjesë e madhe e literaturës është fokusuar te ngritja e lëvizjeve populiste, disa studime analizojnë në mënyrë specifike se si retorika e tyre kontribuon në erozionin e legjitimitetit demokratik. Ky studim ofron një kuptim të ri mbi marrëdhënien midis strategjive të komunikimit populist dhe perceptimit publik të qeverisjes demokratike. Në veçanti, ai hulumton se si retorika përdoret si një mjet nga liderët populistë për të polarizuar shoqërinë dhe për të minuar besimin në institucionet demokratike.

Për më tepër, disertacioni zgjeron diskursin mbi populizmin duke shqyrtuar ndërveprimin midis retorikës, polarizimit social dhe besimit në institucione, të cilat shpesh trajtohen veçmas në literaturën e shkencave politike. Ai ndërthur gjetje nga kërkimet mbi polarizimin në media sociale, diskursin populist dhe psikologjinë politike, për të krijuar një kuadër gjithëpërfshirës për të kuptuar ndikimin në kohë reale të retorikës populiste te besimi publik.

Hipoteza kryesore është se nëse përdorimi i retorikës populiste nga liderët politikë rritet, atëherë do të ketë një erozion gradual të besimit qytetar ndaj institucioneve dhe proceseve demokratike. Ky erozion vjen si rezultat i rritjes së polarizimit social, thellimit të dallimeve shoqërore dhe portretizimit të vazhdueshëm të elitave si të korruptuara dhe të shkëputura nga populli. Duke përdorur imazhe ekzistuese—qoftë ekonomike, kulturore apo politike—liderët populistë përdorin një gjuhë përçarëse që thellon polarizimin, duke çuar përfundimisht në një ulje të besimit në institucionet demokratike.

Metodologjia e përdorur në këtë studim është ndërdisiplinore, duke përfshirë qasje si nomotetike ashtu edhe idiografike për të shqyrtuar kompleksitetin e retorikës populiste dhe ndikimin e saj te besimi demokratik.

Kontributi origjinal i këtij studimi qëndron në analizën e integruar dhe ndërdisiplinare të ndikimit të retorikës populiste në erozionin e besimit demokratik, duke kombinuar për herë të parë në kontekstin shqiptar një metodologji të plotë që ndërthur analiza sasiore (nomotetike) me qasje cilësore interpretuese (idiografike). Për më tepër, ndërsa shumica e studimeve ekzistuese fokusohen kryesisht në rritjen e lëvizjeve populiste apo në efektet politike të tyre, ky studim identifikon mekanizmat specifikë retorikë dhe emocionalë që ndikojnë në perceptimin qytetar të institucioneve demokratike. Ky këndvështrim i nuancuar sjell një kuptim më të thellë të mënyrës sesi populizmi kontribuon në procesin e erozionit demokratik dhe ofron baza të reja për zhvillimin e politikave dhe strategjive për mbrojtjen e demokracisë nga rreziqet populiste.

Kapitulli 2. Rishikim literature

Rritja e populizmit e vërejtur në mbarë botën ka nxitur një numër të konsiderueshme studimesh mbi pasojat e tij për institucionet demokratike. Populizmi kështu është bërë objekti kryesor i kërkimeve politike, me studiues që shqyrtojnë ndikimin e tij në besimin në strukturat politike të ngritura dhe pasojat e mundshme për stabilitetin e demokracive. Ky kapitull synon të ofrojë një analizë të plotë të diskursit akademik aktual mbi populizmin dhe lidhjen e tij me besimin demokratik, duke theksuar se si retorika populiste sfidon parimet themelore demokratike dhe transformon diskursin politik.

Ky shqyrtim i literaturës ofron një përmbledhje të kornizave teorike kryesore dhe definicioneve të populizmit, ashtu siç janë propozuar nga studiues të njohur si Cas Mudde (2004) dhe Ernesto Laclau (2005). Kontributet e tyre ofrojnë perspektiva të kundërta por komplementare mbi populizmin: Mudde e përkufizon si një "ideologji me qendër të hollë", e cila karakterizohet nga ndarja antagonistike midis "popullit" dhe "elitës", ndërsa Laclau e thekson rolin e tij si një "logjikë politike" që ndërton identitete kolektive përmes artikulimit të kërkesave shoqërore. Definimi minimal i Mudde thekson përmbajtjen ideologjike të populizmit, ndërsa qasja diskursive e Laclau fokusohet në mekanizmat përmes të cilëve kjo përmbajtje mobilizohet dhe operacionalizohet në kontekste të caktuara politike. Duke integruar këto korniza konceptuale, ky shqyrtim krijon një bazë teorike për të kuptuar populizmin si një konstrukt ideologjik dhe një proces strategjik, me retorikën që shërben si ura që lidh këto dimensionet dhe mundëson përshtatshmërinë e tij në mjedise të ndryshme politike.

Shqyrtimi i literaturës është organizuar tematikisht, duke filluar me një diskutim mbi konceptualizimin e populizmit dhe karakteristikat e tij kryesore, përfshirë anti-elitizmin, dikotomitë morale dhe strategjitë retorike. Pjesa e mëtejshme shqyrton se si populizmi funksionon si një strategji politike, duke u fokusuar në taktikat e përdorura nga liderët populistë për të krijuar konflikt, delegjitimuar kundërshtarët politikë dhe mobilizuar mbështetje publike. Vëmendje e veçantë i kushtohet rolit të medias në shpërndarjen e ideve populiste, ku shpërthimi i mediave digjitale ka çuar në përhapjen e shpejtë të retorikës polarizuese dhe dezinformatës. Shqyrtimi gjithashtu trajton se si liderët populistë përdorin krizën për të sfiduar institucionet tradicionale dhe për të ndryshuar peizazhin politik.

Përmes këtyre seksioneve tematike, shqyrtimi i literaturës ka theksuar modele të përsëritura të ndikimit të populizmit në kontekste politike të ndryshme. Duke përmbledhur njohuritë teorike dhe gjetjet empirike, ky seksion ka vendosur bazat për të kuptuar se si populizmi minon besimin në proceset dhe institucionet demokratike. Duke bërë këtë, ai identifikon boshllëqe kritike në literaturën ekzistuese dhe vendos themelet për kërkime të mëtejshme mbi mekanizmat përmes të cilëve retorika populiste dëmton stabilitetin demokratik. Kjo analizë formon bazën për seksionet e mëtejshme, të cilat do të fokusohen në eksplorimin empirik dhe metodologjik të këtyre dinamikave.

Operacionalizimi i populizmit

Konceptualizimi i populizmit është diskutuar gjerësisht në literaturën shkencore që nga fillimi i shekullit të 21-të. Një nga perspektivat më me ndikim ka ardhur nga Cas Mudde (2004), i cili e përkufizoi populizmin si një "ideologji me qendër të hollë" që e ndan shoqërinë në dy grupe antagoniste: "populli i pastër" dhe "elitën e korruptuar". Qasja ideologjike e Mudde fitoi popullaritet sepse kapte thelbin e populizmit pa e lidhur atë me orientime të caktuara politike, duke e lejuar populizmin të "udhëtojë" me ideologji të ndryshme, siç e theksuan S. Hunger dhe F. Paxton (2022). Kjo përshtatshmëri shpjegon pse populizmi shfaqet në të gjitha qarqet politike, nga lëvizjet e majta deri te grupet e ekstremit të djathtë. Ndërkohë që "ideologjia me qendër të hollë" e Mudde fokusohet në përmbajtjen ideologjike të populizmit, qasja e Ernesto Laclau (2005) thekson rolin e tij si një "logjikë politike," duke nxjerrë në pah mekanizmat përmes të cilëve ndërtohen identitete kolektive dhe lëvizje. Pavarësisht ndryshimeve të tyre, këto perspektiva mund të sintetizohen.

Mudde (2004) ofroi një përkufizim të qartë dhe operacional të populizmit, i cili është bërë një nga shtyllat kryesore të debatit akademik lidhur me këtë fenomen politik. Qasja e tij thekson thjeshtësinë dhe fleksibilitetin e populizmit si ideologji, komponentët e saj bazë dhe aftësinë e saj për t'u përshtatur me kontekste të ndryshme politike. Sipas perspektivës së përshtatshmërisë, populizmi është një ideologji që pohon se politika duhet të jetë një shprehje e vullnetit të përgjithshëm (*volonté générale*) të popullit. Koncepti i "ideologjisë me qendër të hollë" sugjeron se populizmi nuk ka natyrën e ndërlikuar dhe koherente të ideologjive si socializmi ose liberalizmi, të cilat Mudde i quajti "ideologji me qendër të trasha." Në vend të kësaj, populizmi është një ideologji më fleksibël që mund të bashkohet me ideologji të tjera, më të zhvilluara, si nacionalizmi, socializmi, ose neoliberalizmi (Mudde, 2004). Ideja e "ideologjisë me qendër të hollë" thekson përmbajtjen ideologjike të populizmit, por ndikimi i tij real shfaqet përmes retorikës, e cila e përktheu këtë përmbajtje në veprim. Retorika mundëson që liderët populistë të përshtatin mesazhet e tyre për audiencë dhe kontekste të ndryshme politike, duke ruajtur ndarjen qendrore midis "popullit" dhe "elitës."

Ky fleksibilitet është një element kyç në kuptimin që Mudde ka për populizmin. Si një ideologji me qendër të hollë, populizmi mund të ekzistojë në të gjithë spektrin politik, duke u manifestuar në forma të ndryshme në varësi të kontekstit. Për shembull, ai mund të marrë forma të krahut të djathtë, siç shihet në lëvizjet radikale nacionaliste, ose forma të krahut të majtë, siç janë shembujt e liderëve populistë në Amerikën Latine (Raveau, M. P., et al., 2024). Retorika luan një rol të rëndësishëm në mundësimin e kësaj përshtatshmërie, duke funksionuar si mjet përmes të cilit artikullohet dhe përshtatet ideologjia populiste në kushte të caktuara politike. Retorika, si një mjet artikulumimi, siguron që populizmi të mbetet i përshtatshëm për peizazhe politike të ndryshme, duke ruajtur ndarjen e tij themelore midis "popullit" dhe "elitës."

Një nga komponentët kryesorë të përkufizimit të Mudde është natyra Manikeane e ideologjisë populiste, e cila e paraqet botën në terma të ashpra moralistike.

Retorika populiste e forcon këtë dualizëm duke e paraqitur konfliktin politik si një betejë midis të mirës absolute dhe të keqes absolute, të cilat personifikohen nga populli i virtytshëm dhe elita të korruptuara, përkatësisht (Mudde, 2004). Kjo strategji retorike eliminon nuancat dhe kompleksitetin, duke thjeshtuar realitetet politike në një opozitë binarë që rezonon me emocionet e audiencës. Duke e paraqitur çështjen në këtë kornizë të ashpër morale, liderët populistë pozicionohen si mbrojtës të vetëm të interesave të popullit, ndërsa paraqiten elitër si të moralshëm dhe egoistë. Ky kornizim jo vetëm që i ngre liderët populistë në statusin e përfaqësuesve të vërtetë të popullit, por gjithashtu intensifikon kërcënimin që perceptohet nga elitat.

Retorika luan një rol vendimtar në amplifikimin e kësaj dikotomie. Përmes apelimeve emocionale, populistët mobilizojnë mbështetje duke nxitur zemërim, frikë dhe indinjatë, duke drejtuar këto emocione kundër një "armiku" të përcaktuar qartë. Për shembull, liderët populistë shpesh përdorin gjuhë dhe imazhe reale për të portretizuar elitën si shtypëse që komploton kundër popullit, duke krijuar një ndjenjë urgjence dhe revoltë morale. Në të njëjtën kohë, ata invokojnë idenë e popullit "të pastër" dhe "të bashkuar," duke krijuar një identitet kolektiv që mbështetet në kundërshtimin e elitës dhe grupeve të tjera jashtë. Kjo ndarje moraliste gjithashtu shërben për të delegjitimuar jo vetëm elitën, por çdo opozitë ndaj lëvizjes populiste. Në botëkuptimin populist, ata që nuk pajtohen ose sfidojnë liderin populist, nuk trajtohen si kundërshtarë politikë të legjitimuar me perspektiva alternative; ata shpallen si armiq të popullit. Ky refuzim i pluralizmit dëmton parimet e debatit dhe kompromisit demokratik. Çdo përpjekje për negociata ose pajtim paraqitet si tradhti ndaj vullnetit popullor, duke e thelluar më tej ndarjen antagoniste.

Duke thjeshtuar çështjet politike të ndërlikuara në terma moralë, retorika populiste mundëson që liderët të shmangin diskutimet substanciale politike dhe të përqendrohen në kultivimin e besnikërisë dhe rezonancës emocionale ndërmjet mbështetësve të tyre. Kjo është arsyeja pse Mudde theksoi se populizmi jo vetëm që kundërshton elitizmin, por gjithashtu pluralizmin, i cili vlerëson diversitetin e mendimit dhe njohjen e interesave konkurruese brenda shoqërisë (Mudde, 2004). Refuzimi i pluralizmit është thelbësor për botëkuptimin Manikean, pasi kërkon një konceptim homogjen të "popullit" dhe lë pak hapësirë për mospajtim ose kompromis.

Thelbësor në konceptualizimin e Mudde për populizmin është marrëdhënia midis "popullit" dhe "elitës." Në diskursin populist, "populli" paraqitet si një grup homogjen dhe i virtytshëm që mishëron vullnetin kolektiv dhe sensin e përbashkët të kombit. Megjithatë, siç e theksoi Mudde, përkufizimi populist i "popullit" është shumë selektiv dhe ekskluziv (Mudde, C. 2004). Liderët populistë referohen në një përfaqësim mitik të popullit, i ndërtuar si kundërshtim ndaj elitës dhe çdo grupi tjetër që perceptohet si kërcënim ndaj unitetit ose pastërtisë së kombit (Schroeder, R. 2020).

Kjo mund të përfshijë emigrantët, pakicat etnike ose kundërshtarët politikë, të cilët të gjithë paraqiten si pjesë të elitës ose si të komplotuar me të.

Në anën tjetër të kësaj dikotomie është "elita," e cila paraqitet si një grup i korruptuar dhe vetë-shërbyes që ka humbur lidhjen me popullin. Sipas Mudde, elitat mund të përfshijnë jo vetëm liderët politikë, por gjithashtu elitat ekonomike, intelektualët dhe median—çdo grup që populistët besojnë se ka një ndikim të tepruar në sistemin politik (Mudde, C. 2004). Elitat paraqiten si veprimtarë për interesat e tyre, duke tradhtuar popullin dhe duke minuar procesin demokratik.

Kjo dikotomi është një mjet retorik që përdoret nga liderët populistë për të mobilizuar mbështetje dhe për të delegjitimuar kundërshtarët e tyre. Duke e trajtuar politikën si një luftë midis popullit të drejtë dhe elitave të pabesa, populistët mund të thjeshtojnë çështjet politike të ndërlikuara dhe të apelojnë në emocionet e votuesve. Ky apel emocional është çelësi i suksesit të populistëve, pasi u mundëson liderëve të fitojnë mbështetje, edhe në mungesë të propozimeve të detajuara politike ose programeve koherente politike.

Mudde theksoi marrëdhënien midis populizmit dhe demokracisë liberale si një qëndrim vetëshërbyes nga ana e ideologjisë populiste. Edhe pse populizmi e prezanton veten si një ideologji demokratike, duke pretenduar se përfaqëson vullnetin e vërtetë të popullit, ai bie në kontrast me parimet e demokracisë liberale, të cilat theksojnë pluralizmin, sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të pakicave. Populistët tentojnë ta shohin këto garanci demokratike si pengesa për shprehjen e vullnetit të përgjithshëm, duke argumentuar se ato shërbejnë për të mbrojtur elitën në dëm të popullit (Mudde, C. 2004). Mudde argumentoi se populizmi lulëzon në kohë krize, sidomos kur ka pakënaqësi të gjerë me funksionimin e institucioneve demokratike. Në këtë kontekst, populistët e pozicionojnë veten si jashtë sistemit, duke pretenduar se mund të rikthejnë pushtetin te populli duke shpërbërë institucionet e korruptuara dhe duke anashkaluar normat e miratuara demokratike. Ky qëndrim anti-institucional është veçanërisht i dukshëm në kritikën populiste ndaj sistemit gjyqësor, medias dhe organeve rregullatore të pavarura, të cilat shpesh portretohen si mjete të elitës (Mudde, C. 2004).

Përkufizimi i Cas Mudde për populizmin si një ideologji e ngushtë u bë një koncept thelbësor në studimin e populizmit. Bazuar në këtë, studiues të tillë si J. J. Olivas Osuna (2021) theksuan natyrën multidimensionale të populizmit. Studimi i Osuna propozoi një kuadër që dekonstruon populizmin në pesë dimensione kyçe: paraqitjen e rendit politik, moralitetin, ndërtimin shoqëror, sovranitetin dhe lidhshërinë. Kjo qasje multidimensionale ka ofruar një kuptim më të nuancuar të mënyrës se si funksionon populizmi përtej retorikës së thjeshtë, duke përfshirë jo vetëm komponentët ideologjikë, por gjithashtu elementë ekzekutivë dhe strategjikë.

Ndërkohë, studiues të tillë si P. Rosanvallon (2021) argumentuan se populizmi po rimodelon politikën e shekullit të 21-të duke shfrytëzuar pakënaqësinë publike dhe duke e pozicionuar veten si një përgjigje ndaj dështimeve të perceptuara të demokracisë. Rosanvallon theksoi rolin qendror të

"popullit" në diskursin populist, duke i paraqitur ata si një entitet homogen, i cili duhet të përkthehet menjëherë në veprime politike. Kjo shpesh çon në forma direkte dhe të pa ndërmjetësuar të demokracisë që sfidojnë institucionet tradicionale përfaqësuese. Rosanvallon sugjeron se populizmi jo vetëm që kritikon normat e vendosura demokratike, por gjithashtu kërkon t'i zëvendësojë ato me një marrëdhënie më direkte ndërmjet liderëve dhe popullatës. Ky qëndrim pasqyrohet nga B. De Cleen dhe J. Glynos (2021), të cilët këshillojnë kundër mbështetjes së tepruar në narrativën populiste të "popullit kundër elitës." Ata argumentuan se fokusi i vetëm në këtë binar mund të thjeshtojë në mënyrë të tepruar dinamikat politike të ndërlikuara dhe të anashkalojë dimensione të tjera thelbësore, si roli i politikës së identitetit, faktorët socio-ekonomikë dhe tensionet kulturore, të cilat ndërthuren me populizmin.

Përkufizimi teorik i populizmit mbetet i larmishëm dhe shumëdimensional, duke çuar në interpretime të ndryshme dhe debate mbi elementet e tij thelbësorë. Ky diversitet konceptual komplikon një kuptim të qartë të populizmit, pasi ai përfshin si dimensione ideologjike ashtu edhe strategjike. Qasja e Ernesto Laclau (2005) ndaj populizmit ofron një perspektivë të veçantë që ndryshon nga përkufizimet më konvencionale, si ato të paraqitura nga Cas Mudde. Mudde kryesisht e shihte populizmin përmes lentes së një "ideologjie të fokusuar ngushtë," duke theksuar përshtatshmërinë dhe thjeshtësinë e tij si një kuadër ideologjik që mund të bashkëngjitet me ideologji të tjera, më të gjithanshme. Në ndryshim, Laclau theksoi rolin e populizmit si një logjikë politike, duke u fokusuar në proceset përmes të cilave krijohen identitete dhe lëvizje kolektive. Nëse Mudde përshkruan përmbajtjen e ideologjisë populiste, Laclau thekson mekanizmat për formimin e identiteteve kolektive përmes artikulimit retorik të kërkesave. Kjo sintezë tregon se si populizmi operon si një kuadër ideologjik dhe një strategji diskursive, me retorikën që vepron si urë midis këtyre dimensioneve.

Në vend që ta kufizojë populizmin në një ideologji të fiksuar, Laclau argumentoi se ai funksionon si një mekanizëm përmes të cilit kërkesa të pamundësuar dhe ankesa artikulohen në një identitet të përbashkët politik. Kjo qasje fleksibile lejon që retorika populiste të përshtatet dhe të reagojë ndaj një gamë të gjerë pakënaqësish shoqërore dhe politike, të cilat lindin kur sistemet politike tradicionale dështojnë të adresojnë nevojat e popullit. Kontributi i Laclau ka zgjeruar ndjeshëm fushën e studimeve të populizmit, duke inkurajuar studiuesit të eksplorojnë funksionet e tij diskursive dhe formuese të identitetit brenda peizazhit politik.

Teoria e Laclau është e bazuar në konceptin e artikulimit të kërkesave. Ai argumentoi se populizmi lind kur disa kërkesa të pakënaqura brenda shoqërisë bashkohen në një kërkesë të vetme kundër elitës udhëheqëse ose institucioneve. Sipas Laclau, këto kërkesa individuale janë fillimisht heterogjene dhe të izoluara. Megjithatë, përmes retorikës populiste, ato bëhen ekuivalente në kundërshtimin ndaj elitës, e cila vepron si një armik i përbashkët. Ky proces agregimi e transformon

keqardhjen e izoluar në një vullnet kolektiv, i përfaqësuar nga një lider ose lëvizje populiste (Laclau, E. 2005). Kjo është mënyra se si populizmi krijon një identitet politik për "popullin", i cili është i pozicionuar në opozitë me "elitën e korruptuar".

Një aspekt tjetër kritik i qasjes së Laclau është përdorimi i konceptit të shenjuesve të zbrazët. Për Laclau, liderët ose lëvizjet populiste përdorin koncepte të gjera dhe të paspecifikuara si "populli" ose "drejtësia" për të bashkuar grupe shoqërore të ndryshme. Këta shenjues janë "të zbrazët" në kuptimin që mund të mbushen me kuptime të ndryshme në varësi të kontekstit politik. Ky fleksibilitet mundëson që liderët populistë të tërheqin një gamë të gjerë mbështetësish pa u lidhur me pozita ideologjike të caktuara. Koncepti i shenjuesve të zbrazët jo vetëm që bashkon grupe të ndryshme nën një narrativë të përbashkët, por gjithashtu thekson rolin qendror të retorikës në krijimin e një uniteti strategjik brenda lëvizjeve populiste. Duke përdorur këta shenjues, liderët populistë krijojnë një identitet politik koheziv që kalon përtej ankesa individuale dhe bashkon kërkesat shoqërore të ndryshme nën një flamur të përbashkët. Kjo ndërtim i identitetit politik është thelbësor për strategjinë populiste, duke mundësuar që populistët të mobilizojnë mbështetje dhe të ruajnë përshtatshmërinë ideologjike (Laclau, 2005).

Teoria e Laclau thekson drejtpërdrejt natyrën performative të populizmit. Ai argumentoi se populizmi nuk është thjesht një ideologji ose retorikë, por një proces i vazhdueshëm i ndërtimit dhe mbajtjes së identiteteve shoqërore. Ky proces mbështetet në krijimin dhe forcimin e antagonizmave midis "popullit" dhe elitës, të cilat janë thelbësore për mobilizimin dhe qëndrueshmërinë e lëvizjeve populiste. Retorika luan një rol kyç në mbajtjen e këtyre antagonizmave duke e paraqitur elitën si një kundërshtar monolit dhe të korruptuar ndaj popullit virtytoshëm dhe të bashkuar. Përmes gjuhës emocionalisht të ngarkuar dhe narrativave simbolike, liderët populistë amplifikojnë ndarjen, duke e portretizuar elitën si një kërcënim për vullnetin kolektiv të popullit. Retorika siguron riprodhimin e vazhdueshëm të kësaj opozite binare, e cila është e nevojshme për mobilizimin e mbështetjes dhe ruajtjen e ndikimit politik. Ndryshe nga Cas Mudde, i cili e sheh populizmin si një ideologji të fokusuar ngushtë që bashkohet me ideologji të tjera, Laclau e shihte populizmin si një logjikë politike që mund të përshtatet me një gamë të gjerë sistemesh politike, si demokratike ashtu edhe autoritare.

Ka gjithashtu konceptin e populizmit civilizues, të prezantuar nga I. Yilmaz dhe N. Morieson (2022), të cilët eksploruan se si populistët përdorin retorikën e identitetit civilizues për të forcuar pozitat e tyre politike. Studiuesit kanë argumentuar se në disa kontekste, populizmi merr formë të veçantë kur liderët kundërvënë "civilizimin dhe kulturën tonë" me "të tjerët", duke përdorur simbole kulturore dhe fetare për të bashkuar "popullin e pastër."

Pavarësisht këtyre arritjeve, ka boshllëqe të rëndësishme në studimin e populizmit. S. Hunger dhe F. Paxton (2022) theksuan se shumë nga literaturat ka tendencën të ngatërrojnë populizmin me ideologjitë shoqëruese, duke e bërë të vështirë studimin e populizmit si një fenomen të pavarur. Për

më tepër, Rosanvallon, P. (2021) vuri në dukje se populizmi nuk ka një tekst teorik themeltar të ngjashëm me liberalizmin ose socializmin, duke kufizuar zhvillimin e një kritike koherente të populizmit si ideologji. Kështu, ndërkohë që konceptualizimi i populizmit ka avancuar, fusha ende has vështirësi me qartësinë përkufizuese dhe sfidën e ndarjes së populizmit nga lëvizjet më të gjerë politike dhe shoqërore. Duke sintetizuar qasjet e Mudde dhe Laclau, mund të përmbledhet se populizmi operon si një ideologji e fokusuar ngushtë, e operacionalizuar përmes retorikës, e cila siguron fleksibilitetin dhe përshtatshmërinë strategjike nëpërmjet konteksteve të ndryshme politike.

Varietet e populizmit

Varietet e populizmit

Nënkuptimi i pop-ulizmit si një fenomen kompleks kërkon një analizë të thelluar të varieteteve të tij, të cilat reflektojnë jo vetëm një ndarje ideologjike, por edhe mënyrat e ndryshme të mobilizimit të masave dhe të krijimit të identiteteve politike. Në këtë kontekst, studimet më të fundit kanë identifikuar disa modele kryesore që përfaqësojnë variantët e pop-ulizmit, ndër të cilat ndërthuren elemente të të majtës radikale dhe të djathtës radikale, si dhe forma hibride që tejkalojnë ndarjen tradicionale. Kjo analizë synon të zbulojë strukturat themelore të këtyre modeleve, të cilat kontribuojnë në mënyrën se si retorika populiste përdoret për të delegitimuar institucionet demokratike dhe për të krijuar një ndjenjë të përbashkët të zhgënjimit midis qytetarëve (Mudde, 2004; Laclau, 2005).

Një nga kategoritë kryesore të pop-ulizmit është ajo e të djathtës radikale, e cila thekson ndarjen midis "popullit të pastër" dhe "elitës së korruptuar". Ky model, i cili ka marrë vëmendje të konsiderueshme në studimet ndërkombëtare, përdor gjuhë polarizuese që nxjerr në pah shqetësimet kombëtare dhe identitetin kulturor. Në këtë kuadër, retorika e të djathtës radikale shpesh përfshin elemente të nacionalizmit dhe anti-imigracionit, duke argumentuar se institucionet demokratike janë të përbuzura nga influenca e jashtme dhe nga përpjekjet e elitave për të ruajtur status quo-në. Studimet kanë treguar se në vende si Hungaria dhe Italia, këto mesazhe polarizuese kanë kontribuar në një ulje të ndjeshme të besimit në institucionet publike (Eatwell & Goodwin, 2018). Në këtë kontekst, gjuhët populiste përdoren për të mobilizuar mbështetje në kohë krize, duke krijuar një narrativë që e prezanton institucionin si një mjet që shërben interesave të një elite të vogël, ndërkohë që nevojat e popullit lihen pa përfaqësim të duhur.

Nga ana tjetër, modeli i të majtës radikale thekson çështje socio-ekonomike dhe padrejtësi që prek grupet më të prekura. Ky lloj pop-ulizmi përdor një retorikë që kritikon sistemin ekonomik dhe përshkruan institucionet si struktura që favorizojnë interesat e elitave të vogla, duke minuar mundësitë e përbashkëta për një shpërndarje të drejtë të pasurisë. Në intervistat dhe studimet empirike ndërkombëtare, qytetarët që përballen me sfida ekonomike theksojnë ndjenjën e pashpresës dhe

mungesën e përfaqësimit, e cila forcohet nga mesazhet populiste që e thjeshtojnë realitetin në një binar të ashpër midis "punëtorëve" dhe "elitës së pasur" (Norris & Inglehart, 2019). Ky model, që shpesh ndikohet nga faktorë si globalizimi dhe politikë neoliberalë, nxjerr në pah nevojën për masa që të rikthejnë drejtësinë dhe barazinë ekonomike.

Një dimension i tretë që po merr vëmendje është pop-ulizmi civilizues, i cili përfshin elemente të retorikës kulturore dhe të identitetit civil. Ky model përdor simbole, metafora dhe narrativë që theksojnë vlerat tradicionale dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Në disa rajone të Evropës Jugore dhe në disa vende të Amerikës Latine, pop-ulizmi civilizues është përdorur për të nënvizuar rëndësinë e një identiteti kulturor të përbashkët dhe për të kundërshtuar ndikimet e globalizmit që shpesh perceptohen si kërcënime ndaj unitetit kulturor (Mudde & Kaltwasser, 2017). Këto forma të pop-ulizmit kanë efekt të ndryshëm në perceptimet e qytetarëve, pasi ato mund të krijojnë një ndjenjë krenarie kombëtare, por gjithashtu mund të rezultojnë në ndarje kulturore dhe tensione ndërmjet grupeve të ndryshme brenda shoqërisë.

Një tjetër nënsektor që është rëndësor për literaturën moderne është pop-ulizmi transnacional, i cili thekson se në epokën dixhitale, retorika populiste nuk kufizohet vetëm në vendin e një qytetari, por prek audienca ndërkombëtare. Ky model përfshin një retorikë që sfidon institucionet ndërkombëtare dhe organizatat globale, duke i portretizuar ato si struktura që nuk përfaqësojnë vullnetin e popullit në një kontekst global (Mudde & Rovira Kaltwasser, 2017). Në këtë mënyrë, pop-ulizmi transnacional thekson nevojën për një redistribucion të fuqisë dhe për një dialog ndërkombëtar, duke u përpjekur të rikthejë besimin në institucionet globale përmes një komunikimi që është i drejtpërdrejtë dhe i bazuar në çështje kombëtare.

Në një analizë të thelluar të literaturës, është e rëndësishme të theksohet gjithashtu ndikimi i mjedisit dixhital. Studimet më të fundit tregojnë se rrjetet sociale dhe platformat dixhitale kanë transformuar mënyrën e shpërndarjes së retorikës populiste. Kjo qasje dixhitale jo vetëm që përshpejton përhapjen e mesazheve, por gjithashtu kontribuon në krijimin e një ambienti ku ndjenjat emocionale dhe perceptimet personale për institucionet formohen shpejt dhe pa filtrim. Për shembull, analizat e mediat dixhitale kanë evidentuar se konsumimi i informacionit nga rrjetet sociale korrelacionohet me një ulje të besimit institucional, duke përforcuar efektet e retorikës polarizuese (Norris & Inglehart, 2019).

Ky studim përdori intervista gjysmë të strukturuar për të mbledhur të dhëna cilësore, duke ndjekur një protokoll të standardizuar që siguroi konsistencën e qasjes. Kjo metodë u zgjodh për shkak të fleksibilitetit të saj dhe aftësisë për të ofruar një kuptim të thellë të eksperiencave dhe perceptimeve të pjesëmarrësve mbi retorikën populiste. Pjesëmarrësve iu bënë pyetje të hapura rreth perceptimeve të tyre mbi mesazhet populiste, ndikimin e tyre emocional dhe ndikimin në besimin në institucionet demokratike. Pyetjet e ndjekura mundësuan sqarimin e temave të reja që u gjeneruan gjatë diskutimit, të cilat kontribuan në një thellim të mëtejshëm të analizës.

Përdorimi i kampionimit jo probabilitar siguroi përfaqësimin e grupeve të ndryshme demografike në aspektet e moshës, gjinisë, nivelit të arsimit dhe orientimit politik. Tetë pjesëmarrës nga Shqipëria morën pjesë në studim, të zgjedhur për të siguruar përfaqësim të ndryshëm. Karakteristikat demografike përfshinin një balancë grupe moshash (18–65 vjeç), gjinisë dhe nivelit

të arsimit. Ky diversitet ishte thelbësor për të marrë një gamë të gjerë perspektivash mbi retorikën populiste dhe ndikimin e saj në besimin në institucionet demokratike. Pjesëmarrës të tjerë, gjithashtu, u përfshinë nga 4 shtete të tjera për një krahasim ndër-kontekstual, duke mundësuar perspektiva të ndryshme sociokulturore. Qëllimi kryesor i intervistave ishte të mblidheshin të dhëna cilësore të detajuara mbi mënyrën se si pjesëmarrësit e perceptuan retorikën populiste, si e interpretuan atë dhe si ndikoi në besimin e tyre në institucionet demokratike. Intervistat gjithashtu mundësuan një vlerësim të pikëpamjeve të pjesëmarrësve mbi efektivitetin e liderëve populistë në trajtimin e çështjeve shoqërore dhe eksplorimin e mundësisë që këto pikëpamje të ndikojnë në pjesëmarrjen e tyre në proceset demokratike.

Intervistat gjysmë të strukturuar luajtën një rol kritik në kuptimin e eksperiencave dhe perspektivave subjektive të pjesëmarrësve. Ato ofruan një format të strukturuar që, njëkohësisht, lejonte kërkuesin të devijonte nga plani kryesor për të eksploruar tema relevante që shpërthyen gjatë diskutimeve. Mostra u zgjodh duke marrë parasysh faktorë të tillë si niveli i ekspozimit të pjesëmarrësve ndaj retorikës populiste, angazhimi i tyre në institucionet demokratike dhe orientimi politik, të cilat rritën thellësinë dhe besueshmërinë e rezultateve të marra.

Për pjesën kuantitative, u administruan anketa në një mostër përfaqësuese të popullsisë. Këto anketa u dizajnuan me kujdes për të matur aspekte kryesore të besimit në institucionet demokratike, pikëpamjet mbi liderët populistë dhe hapjen ndaj narrativave populiste. Për komponentin kuantitativ të studimit, u zhvillua një anketë me një mostër përfaqësuese të popullsisë. Anketa u realizua në gusht 2024. 985 respondentë nga rajone të ndryshme të vendit morën pjesë, duke mundësuar një mostër demografike të gjerë sipas moshës, gjinisë, nivelit të arsimit dhe orientimit politik. Qëllimi i anketës ishte të analizohej ndjeshmëria ndaj retorikës populiste në varësi të nivelit të arsimit të respondentëve dhe ekspozimit ndaj retorikës populiste. Studimi fokusohet në mënyrën se si grupe të ndryshme arsimore perceptojnë narrativat populiste dhe nëse ato ishin të prirura të mbështesnin liderë që përdorin apelime emocionale, të thjeshta ose radikale. Përdorimi i një mostre të stratifikuar sipas nivelit të arsimit u përdor për të zgjedhur respondentët. Kjo teknikë rriti vlefshmërinë e gjetjeve duke reflektuar perspektivat dhe karakteristikat e ndryshme të popullsisë.

Të dhënat e mbledhura u analizuan përmes regresionit logjistik shumë-kategorik. Analiza u fokusua në identifikimin e lidhjes midis ndikimit të retorikës populiste dhe nivelit të besimit në institucionet demokratike, duke marrë parasysh variablat kontrollues si niveli i arsimit.

Kombinimi i intervistave gjysmë të strukturuar dhe anketimeve të strukturuar pasuroi studimin duke ofruar si thellësi cilësore të të dhënave, ashtu edhe gjetje kuantitative të përgjithshme. Kjo qasje metodologjike e përzier siguroi një ekzaminim të plotë të efekteve të retorikës populiste mbi besimin publik në institucionet demokratike. Duke integruar këto dy forma të të dhënave, studimi mundi të triangulonte gjetjet, duke rritur besueshmërinë e rezultateve dhe ofruar një kuptim më

holistik të fenomenit të hetuar. Ky qasje metodologjike i mundësoi kërkimit të nxirrte përfundime të nuancuara mbi lidhjen mes retorikës populiste dhe rënies së besimit në proceset demokratike.

Shpërndarja e anketave

Qarku	Urban	Rural	Total
Tirane	250	101	351
Durres	70	31	101
Shkoder	55	26	81
Elbasan	55	26	81
Fier	55	26	82
Vlore	42	18	60
Korce	35	15	50
Berat	28	12	40
Lezhe	28	12	40
Gjirokaster	28	12	40
Kukes	21	9	30
Diber	21	9	30
Total	700	285	985

Burimi: Te dhenat e autorit

Pjesëmarrësit

Për këtë studim, u zgjodhën dy grupe pjesëmarrësish: pjesëmarrësit në anketë dhe ata në intervista. Të dy grupet u zgjodhën për të siguruar të dhëna përfaqësuese mbi nivelin e besimit në institucionet demokratike dhe ndikimin e retorikës populiste mbi opinionin publik. Zgjedhja e pjesëmarrësve për anketën siguroi diversitet në karakteristikat demografike, duke mundësuar mbledhjen e një spektri të gjerë mendimesh dhe pikëpamjesh. Grupi i respondentëve kishte një moshë prej 18 deri në 65 vjeç. Balanca gjinore u ruajt relativisht me tregues të përbërjes 52% meshkuj dhe 48% femra. Pjesëmarrësit në anketë përfshinin individë me nivele të ndryshme arsimimi dhe preferenca të ndryshme politike, si dhe individë që nuk kishin një orientim politik specifik ose që shfaqnin mosbesim ndaj sistemit të partive. Ky faktor siguroi një diversitet pikëpamjesh politike ndërmjet respondentëve.

Për intervistë, numri i pjesëmarrësve ishte 8 individë, të cilët u zgjodhën duke përdorur metodën e mostërzimit të synuar (purposive sampling). Pjesëmarrësit kishin nivele të ndryshme arsimit, nga shkolla e mesme deri në diplomë masteri, që siguronin një variacion të niveleve të perceptimit të

retorikës populiste. Intervistat përfshinin respondentë nga grupe të ndryshme moshorash (18–65 vjeç). Balanca gjinore u arrit (4 meshkuj, 4 femra), e cila siguroi balancë gjinore në studim (Tabela 1). Identiteti i secilit pjesëmarrës është anonimizuar për të ruajtur konfidencialitetin.

Table 1. Profili politik dhe demografik i të intervistuarëve

Participant no.	Gender	Age	Education level	Political orientation
P1	F	24	Bachelor's degree	Liberal
P2	M	38	College degree	Populist-leaning
P3	F	52	Master's degree	Conservative
P4	M	29	Some College, no degree	Populist supporter
P5	F	46	Bachelor's degree	Unaffiliated
P6	M	34	High school diploma	Unaffiliated, social equality supporter
P7	F	61	Master's degree	Conservative
P8	M	22	Bachelor's degree	Liberal

Burimi: Te dhenat e autorit

Në përpjekjen për të kuptuar ndikimin e retorikës populiste mbi perceptimin e institucioneve demokratike, një nga aspektet më të rëndësishme të këtij studimi është analiza e intervistave të realizuara në pesë vende: Shqipëri, Hungari, Itali, Shtetet e Bashkuara dhe Francë. Ndërsa pjesa e parë e analizës ishte e fokusuar tek intervistat me pjesëmarrës nga Shqipëria, ky seksion synon të zgjerojë më tej kuadrin kërkimor duke shqyrtuar sesi populizmi perceptohet në vende me kontekste të ndryshme politike, historike dhe kulturore. Nëpërmjet një analize të detajuar të intervistave, do të eksplorojmë sesi qytetarët e këtyre vendeve e përjetojnë populizmin, si e lidhin atë me institucionet demokratike dhe si ndikimi i tij ndryshon në varësi të faktorëve politikë dhe socio-ekonomikë.

Në Hungari, populizmi është bërë pjesë e qeverisjes dhe ka ndikuar drejtpërdrejt në strukturën e institucioneve demokratike. Pjesëmarrësit në intervista shfaqën një ndarje të thellë në perceptimin e qeverisjes populiste dhe ndikimit të saj në demokracinë e vendit. Për disa prej tyre, populizmi shihej si një mekanizëm i fuqishëm për të mbrojtur identitetin kombëtar dhe për të kundërshtuar ndërhyrjet e huaja, veçanërisht ato nga Bashkimi Evropian. Ata theksonin se retorika populiste ka ndihmuar në krijimin e një ndjenje sigurie dhe stabiliteti, duke përforcuar besimin në një lider të fortë që mbron vlerat tradicionale hungareze. Në të kundërt, një pjesë tjetër e pjesëmarrësve shprehnin shqetësimin e tyre mbi erozionin e institucioneve demokratike, kufizimin e pluralizmit politik dhe përqendrimin e pushtetit në duart e një grupi të vogël politik. Ata argumentonin se kontrolli mbi median dhe dobësimi i opozitës politike kanë minuar pavarësinë institucionale dhe e kanë bërë më të vështirë një

konkurrencë politike të drejtë. Ky dualizëm në perceptim tregon se populizmi në Hungari nuk është vetëm një formë retorike, por një strategji qeverisëse që ndikon në mënyrën se si qytetarët e perceptojnë demokracinë dhe rolin e institucioneve në garantimin e saj.

Në Itali, intervistat treguan një realitet të ndryshëm, ku populizmi nuk është i institucionalizuar në të njëjtën mënyrë si në Hungari, por mbetet një fenomen i fuqishëm politik që përsëritet dhe transformohet në varësi të situatës politike dhe ekonomike. Pjesëmarrësit e intervistuar shprehën një shkallë të lartë zhgënjimi me sistemin politik dhe e shihnin populizmin si një formë reagimi kundër korrupsionit dhe stagnimit të klasës politike. Shumë prej tyre theksonin se liderët populistë kanë arritur të kapin ndjenjat e zhgënjimit të qytetarëve duke premtuar ndryshime të shpejta dhe rrënjësore. Në veçanti, të rinjtë e intervistuar e konsideronin populizmin si një lëvizje të nevojshme për të thyer një sistem të mbingarkuar nga burokracia dhe nepotizmi. Nga ana tjetër, pjesëmarrësit më të moshuar tregoheshin më skeptikë, duke argumentuar se populizmi nuk kishte sjellë ndryshime të qëndrueshme dhe se premtimet e tij shpesh rezultonin të zbrazëta ose të pamundura për t'u realizuar. Në këtë mënyrë, intervistat në Itali pasqyruan një populizëm më pragmatik dhe më të lëvizshëm, i cili nuk ka krijuar ende një strukturë të qartë institucionale, por që gjithsesi vazhdon të ketë ndikim të madh në mënyrën sesi qytetarët e perceptojnë qeverisjen dhe institucionet demokratike.

Në Shtetet e Bashkuara, analizat e intervistave reflektuan një polarizim të fortë politik dhe një ndarje të qartë midis mbështetësve dhe kritikëve të populizmit. Pjesëmarrësit që ishin të prirur të mbështesnin leadershipin populist argumentonin se populizmi kishte sjellë një ndryshim të rëndësishëm duke sfiduar establishmentin politik dhe duke u dhënë një zë shtresave që ndiheshin të përjashtuara nga vendimmarrja politike. Sipas tyre, qasja populiste i kishte dhënë një qeverisjeje më të drejtpërdrejtë dhe më të ndjeshme ndaj shqetësimeve të qytetarëve të zakonshëm. Nga ana tjetër, kritikët e këtij fenomeni shprehnin shqetësimin se populizmi kishte minuar normat demokratike, kishte fuqizuar narrativat përçarëse dhe kishte krijuar një kulturë politike që mbështetej më shumë në retorikë sesa në politika të qarta dhe të qëndrueshme. Një element interesant që doli nga intervistat ishte roli i mediave sociale në përhapjen e diskurseve populiste dhe ndihma që ato kanë dhënë në formësimin e një realiteti politik të fragmentuar dhe të ndarë sipas linjave ideologjike. Në këtë kontekst, SHBA përfaqëson një rast ku populizmi nuk është vetëm një strategji politike, por edhe një forcë transformuese që ka ndikuar në mënyrën se si qytetarët i perceptojnë institucionet dhe demokracinë.

Në Francë, populizmi është i lidhur ngushtë me çështjet e identitetit kombëtar dhe sovranitetit. Intervistat me pjesëmarrësit në këtë vend treguan një qasje të ndryshme ndaj populizmit në krahasim me kontekstet e tjera. Mbështetësit e diskurseve populiste argumentonin se globalizimi dhe emigracioni po cenonin thelbin e identitetit francez dhe se vetëm një qasje e fortë populiste mund të mbronte kulturën dhe traditat kombëtare. Ata e shihnin populizmin si një mjet për të rivendosur

kontrollin kombëtar dhe për të kundërshtuar atë që e konsideronin si një elitë politike të shkëputur nga realiteti i qytetarëve. Në të kundërt, kritikët e populizmit e konsideronin këtë qasje si të rrezikshme dhe përçarëse, duke argumentuar se narrativat populiste shpesh shfrytëzojnë ndjenjat e pasigurisë për të rritur mbështetjen e tyre, në vend që të ofrojnë zgjidhje të vërteta për problemet e shoqërisë franceze. Një tjetër aspekt i rëndësishëm që doli nga intervistat ishte perceptimi mbi Bashkimin Evropian, me disa pjesëmarrës që e shihnin atë si një kufizues të sovranitetit francez, ndërsa të tjerët e konsideronin atë si një garanci për stabilitetin ekonomik dhe politik të vendit.

Në përmbledhje, analiza e intervistave tregon se populizmi nuk është një fenomen i njëjtë në të gjitha vendet, por përshtatet dhe transformohet sipas realitetit politik dhe kulturor të secilit vend. Në Hungari, ai është institucionalizuar dhe ka ndikuar në dobësimin e institucioneve demokratike, ndërsa në Itali ai mbetet një fenomen i lëvizshëm që sfidon sistemin ekzistues. Në SHBA, ai është bërë një forcë polarizuese që ndikon në perceptimin e qytetarëve për realitetin politik, ndërsa në Francë, populizmi është i lidhur kryesisht me identitetin kombëtar dhe sovranitetin. Ky krahasim tregon se, pavarësisht dallimeve midis vendeve, një tipar i përbashkët i populizmit është aftësia e tij për të sfiduar legjitimitetin e institucioneve demokratike duke ndërtuar një narrativë të thjeshtuar mbi konfliktin midis "popullit të vërtetë" dhe elitave politike.

Analiza e përmbajtjes

Fjalimet, deklaratat mediatike dhe postimet në mediat sociale të liderëve populistë u analizuan duke përdorur kodimin tematik në softuerin NVivo. Kjo metodë identifikoi sistematikisht temat dhe strategjitë retorike që përsëriten, duke përfshirë krijimin e një dykahësie të qartë midis "popullit" dhe "elitave." Temat kryesore të analizës përfshinin dykahësinë morale, apelimet emocionale dhe përpjekjet për delegjitimizimin e kundërshtarëve. Korniza e kodimit u testua për konsistencën mes koduesve, duke arritur një vlerë Cohen's Kappa prej 0.84, që tregon besueshmëri të lartë dhe konsistencë të rezultateve.

Analiza e përmbajtjes zbuloi modelet në përdorimin e retorikës që portretizonin elitën si të korruptuar, të pamoralshëm dhe të shkëputur nga qytetarët e zakonshëm. Liderët populistë shpesh poziciononin veten si mbrojtës të vullnetit të vërtetë të popullit, duke theksuar autentikitetin dhe superioritetin e tyre moral. Mesazhet e tyre zakonisht përfshinin thirrje për një kthim në vlerat tradicionale ose premtime për rinovim politik që ngjallnin ndjenja nostalgjike dhe apelonin te ata të zhgënjyer nga sistemet ekzistuese. Për më tepër, liderët përdornin gjuhë të ngarkuar emocionalisht për të evokuar frikë, zemërim ose shpresë, duke mobilizuar me efikasitet mbështetësit e tyre.

Kodimi sistematik na mundësoi të vlerësonim frekuencën dhe intensitetin e këtyre strategjive retorike, të cilat kontribuan në një kuptim të matshëm të ndërtimit të retorikës populiste. Për shembull, fjalët që lidhen me dënonimin moral, si "tradhti," "korruptim," ose "armik," u gjetën rregullisht në

përshkrimet e elitës. Liderët gjithashtu përdornin fraza që theksonin unitetin, identitetin dhe ankesat e përbashkëta për të ndërtuar solidaritet me audiencën e tyre, duke forcuar idenë se vetëm ata përfaqësonin interesat e vërteta të popullit.

Kombinimi i analizës së përmbajtjes dhe intervistave cilësore mundësoi një kuptim më të plotë të retorikës populiste. Ndërsa analiza e përmbajtjes ofroi prova të matshme të strategjive retorike që përsëriten, gjetjet cilësore zbuluan përvojat dhe perceptimet e individëve të ndikuar nga këto mesazhe. Ky qasje e dyfishtë gjithashtu theksoi se si liderët populistë e përshtatin gjuhën e tyre për t'u përgjigjur ndaj konteksteve të ndryshme, duke e rafinuar retorikën për të reaguar ndaj çështjeve politike dhe sociale që shfaqen.

Duke identifikuar dhe kategorizuar këto strategji, studimi illustroi se si liderët populistë ndajnë dhe përhapin një narrativë që forcon pozicionin e tyre politik. Kjo qasje ofroi një pamje më të qartë të rolit që luajnë strategjitë retorike në mobilizimin e mbështetjes, polarizimin e shoqërive dhe dobësimin e besimit në institucionet demokratike. Integrimi i të dhënave cilësore dhe të dhënave të matshme forcoi besueshmërinë e këtyre gjetjeve, duke ofruar një perspektivë të nuancuar dhe të bazuar në prova mbi ndikimin e retorikës populiste. Kjo analizë e plotë kontribuon në kuptimin më të gjerë të mënyrës se si liderët populistë e përdorin efektivisht gjuhën për të ndikuar në perceptimin publik dhe për të formësuar diskursin politik.

Teknikat e analizës së të dhënave

Të dhënat e intervistave cilësore në këtë studim u analizuan përmes analizës tematike, e cila përfshin identifikimin e modeleve dhe temave kryesore brenda transkripteve të intervistave. Kjo qasje u projektua për të zbuluar kuptimet më të thella dhe perceptimet lidhur me retorikën populiste. Përdorimi i softuerit NVivo mundësoi organizimin dhe kodimin sistematik të të dhënave, duke siguruar një ekzaminim të plotë të modeleve që përsëriten. Aftësitë e softuerit mundësuan kategorizimin efikas, duke bërë të mundur fokusimin në aspekte specifike të retorikave populiste, si apelimet emocionale ose ndjenjat anti-elitë.

Për të thelluar analizën, modeli Doc2Vec u përdor për të kuantifikuar marrëdhëniet semantike brenda teksteve të intervistave/fjalimeve. Doc2Vec, një algoritëm i bazuar në rrjete neuronale, u aplikua për të kapur ngjashmëritë kontekstuale dhe modelet gjuhësore. Ky mjet mundësoi identifikimin e modeleve nënkuptimore që mund të mos ishin menjëherë të dukshme përmes kodimit tradicional. Për shembull, Doc2Vec ndihmoi në grumbullimin e shprehjeve të ngjashme të zhgënjimit dhe alienimit, duke krijuar grupe përgjigjesh që pasqyrojnë perspektiva të përbashkëta mbi retorikën populiste. Ky përfaqësim i avancuar e tekstit ofroi shtresa shtesë të kuptimit, duke plotësuar analizën tematike dhe duke theksuar struktura gjuhësore të zakonshme që lidhen me narrativat populiste.

Më pas, studimi aplikoi analizën e regresionit për të dhënat e anketës për të eksploruar korrelacionin midis ekspozimit ndaj retorikës populiste dhe niveleve të besimit politik. Modelet e regresionit u zhvilluan për të matur ndikimin e retorikës populiste në besimin në institucionet demokratike, duke kontrolluar për faktorë demografikë thelbësorë. Duke përfshirë variabla si mosha, arsimi dhe të ardhurat, analiza mori parasysh ndikimet e mundshme në mënyrën se si individët perceptojnë mesazhet populiste dhe besimin e tyre në proceset demokratike.

Kjo qasje e kombinuar e analizës tematike cilësore dhe analizës statistikore kuantitative ofroi një kuptim shumëdimensional të ndikimit të retorikës populiste. Nga njëra anë, komponenti cilësor ndriçoi hollësitë dhe interpretimet subjektive të mesazheve populiste. Narrativat e pjesëmarrësve pasqyronin ndjenja zhgënjimi ose një ndjenjë alienimi nga politika kryesore, tema që forcoheshin vazhdimisht përmes retorikës populiste.

Nga ana tjetër, analiza kuantitative e vërtetoi dhe zgjeroi këto gjetje duke kuantifikuar shkallën në të cilën këto narrative ishin të përhapura dhe duke identifikuar marrëdhënie statistike të rëndësishme. Për shembull, analiza e regresionit zbuloi se ekspozimi i shtuar ndaj mesazheve populiste korrespondonte me nivele më të ulëta besimi në institucionet demokratike, veçanërisht midis grupeve demografike të caktuara.

Kjo metodologji gjithëpërfshirëse mundësoi që studimi të nxirrte përfundime më të sakta dhe të përgjithësueshme mbi ndikimin e retorikës populiste në besimin publik. Integrimi i teknikave cilësore dhe kuantitative siguroi një analizë të fortë, duke kapërcyer kufizimet e secilës qasje kur përdoret veç e veç. Të dhënat cilësore ofruan thellësi dhe kontekst, duke kapur aspektet personale dhe emocionale të retorikës populiste, ndërkohë që të dhënat kuantitative lejuan përgjithësime më të gjera dhe rigorizitet statistik.

Triangulimi i të dhënave

Ky studim përdori një metodë triangulimi për të përmirësuar vlefshmërinë dhe besueshmërinë e rezultateve, duke integruar disa qasje kërkimore—cilësore, kuantitative dhe analizë përmbajtjesh. Kjo qasje siguroi validimin e rezultateve, duke mundësuar një kuptim gjithëpërfshirës të fenomenit dhe duke minimizuar mundësitë e pasaktësive. Të dhënat cilësore nga intervistat gjysmë të strukturuar ofruan njohuri të thella mbi perceptimet e individëve ndaj retorikës populiste, ndërsa metodat kuantitative ofruan rezultate statistike të qëndrueshme mbi trendet e përgjithshme të besimit në institucionet demokratike. Për më tepër, analiza përmbajtjes shqyrtoi në mënyrë sistematike strategjitë retorike të liderëve populistë, duke identifikuar tema kyçe dhe frekuencën e përdorimit të tyre. Triangulimi përfshinte krahasimin e të dhënave nga burime të ndryshme—përgjigje subjektive të intervistave, metrika objektive të anketave dhe rezultatet e analizës përmbajtjesh. Ky proces mundësoi marrjen parasysh të dallimeve midis metodave, të cilat u analizuan me kujdes, dhe u

mbloodhën të dhëna shtesë për sqarim kur ishte e nevojshme. Kjo qasje ofroi një pamje më të saktë dhe gjithëpërfshirëse të ndikimit të retorikës populiste në besimin në institucionet demokratike.

Një komponent kyç i sigurisë së transparencës dhe riprodhueshmërisë së rezultateve ishte implementimi i një gjurmë auditimi që dokumentoi të gjitha vendimet e kodimit të të dhënave. Kjo siguroi qartësi dhe qëndrueshmëri në përdorimin e metodave të analizës. Përdorimi i qasjeve të shumëfishta analitike e forcoi ndjeshëm robustësinë metodologjike të studimit. Të dhënat cilësore shtuan thellësi kontekstuale, ndërsa anketat kuantitative ofruan rezultate të përgjithësueshme. Në të njëjtën kohë, analiza përmbajtjesh i shtoi një nivel analize sistematike duke koduar dhe kategorizuar elementët kryesorë retorikë, duke mundësuar krahasime kuantitative të fjalimeve dhe strategjive të liderëve.

Kombinimi i intervistave cilësore, anketimeve kuantitative dhe analizës përmbajtjesh jo vetëm që forcoi besueshmërinë e gjetjeve, por gjithashtu kontribuo në vlefshmërinë e tyre. Çdo metodë plotësoi tjetrën, duke ofruar dëshmi të mbivendosura dhe duke forcuar besueshmërinë e përgjithshme të studimit. Triangulimi gjithashtu mundësoi një interpretim më të nuancuar të gjetjeve, pasi secila metodë theksoi aspekte të veçanta por të ndërthurura të marrëdhënies midis retorikës populiste dhe besimit në proceset demokratike.

Konkluzione

Korniza metodologjike e këtij studimi ka për qëllim të ofrojë një analizë gjithëpërfshirëse të ndikimit të retorikës së liderëve populistë në besimin në proceset demokratike. Duke kombinuar perspektivat nomotetike dhe ideografike, metodat cilësore dhe kuantitative, dhe analizën përmbajtjesh, studimi identifikoi mekanizmat përmes të cilëve retorika populiste dëmton besimin demokratik. Kjo qasje kontribuo në një kuptim më të thellë të ndërveprimit dinamik midis liderëve populistë, retorikës dhe besimit politik, duke ofruar informacione të vlefshme për studiuesit, politikanët dhe praktikuesit që punojnë për të adresuar sfidat që sjell populizmi. Seksioni i Materialeve dhe Metodave të tezës hapi bazën për kërkimin empirik, duke siguruar që gjetjet kërkimore të jenë të qarta, të riprodhueshme dhe të mbështetura në një kornizë analitike rigorozë. Duke përshkruar qartë dizajnin e kërkimit, mbledhjen e të dhënave dhe metodat e analizës, ky seksion ofron një bazë të fortë për seksionet e mëtejshme, të cilat do të prezantojnë gjetjet empirike dhe ndikimet e tyre për stabilitetin demokratik.

Kapitulli 4. Rezultate

Analiza e retorikës populiste në fjalimet politike

Përdorimi i retorikës populiste në diskursin politik është kthyer në një tipar dallues të politikës bashkëkohore. Me një apel të fortë emocional dhe me një dualizëm moralizues, kjo lloj retorike shërben si një mjet i fuqishëm për mobilizimin e mbështetjes publike, veçanërisht gjatë periudhave të paqëndrueshmërisë politike apo ekonomike. Liderë si Viktor Orbán, Donald Trump, Recep Tayyip Erdoğan dhe të tjerë e kanë përdorur me efektivitet retorikën populiste për të forcuar bazën e tyre politike, për të minuar institucionet demokratike dhe për të krijuar mosbesim ndaj normave të vendosura. Kjo pjesë trajton karakteristikat kryesore të retorikës populiste, përdorimin e saj në diskursin politik dhe ndikimin e saj në dinamikën politike dhe në besimin demokratik.

Në thelb të retorikës populiste qëndron paraqitja binare e politikës si një betejë midis "popullit" dhe "elitës." Ky dualizëm, që është qendror për konceptualizimin e populizmit si një "ideologji e hollë" nga Kas Mudde (2004), është baza e shumicës së diskurseve populiste. Në këto narrativa, "populli" idealizohet si një grup i bashkuar dhe moralisht superior, ndërsa "elita" përshkruhet si e korruptuar, egoiste dhe e shkëputur nga nevojat e popullit. Ky kornizim dualist thjeshton çështjet komplekse shoqërore, duke u dhënë mundësi liderëve populistë të shfrytëzojnë ndasitë sociale dhe të pozicionohen si përfaqësuesit e vetëm autentikë të "popullit."

Për të ilustruar këto dinamika, u krye një analizë e thelluar e retorikës së Viktor Orbán-it. Analiza u përqendrua në një korpus që përfshinte fjalimet dhe deklaratat e tij publike kryesore gjatë periudhës 2020–2024 (Tabela 2). Ky korpus u analizua sistematikisht për të zbuluar temat përsëritëse, strategjitë retorike dhe ndërtimet narrative që janë thelbësore për stilin udhëheqës të Orbán-it. Gjetjet paraprake sugjerojnë se Orbán përdor vazhdimisht strategji populiste, duke përfshirë dënimin moral të elitës, apele ndaj identitetit kombëtar dhe thirrje për t'u kthyer te vlerat tradicionale. Kjo qasje e forcon pozicionin e tij si një mbrojtës i interesave të kombit, ndërsa marginalizon kundërshtarët politikë dhe minon besueshmërinë e institucioneve demokratike.

Duke analizuar në mënyrë sistematike retorikën e Orbán-it së bashku me diskurset më të gjera populiste, kjo pjesë synon të hedhë dritë mbi mekanizmat përmes të cilëve liderët populistë ndikojnë diskursin politik dhe gërryejnë besimin në sistemet demokratike. Kjo analizë jo vetëm që thekson strategjitë retorike të përdorura, por gjithashtu i pozicionon ato brenda konteksteve më të gjera politike dhe socio-ekonomike që i bëjnë ato të rezonojnë me publikun.

Tabela 2. Përmbledhje e fjalimeve të Viktor Orbán

Data	Speech Occasion
19 February 2020	State of the Nation
21 September 2020	Opening of the Hungarian Parliament
6 June 2020	Commemoration speech
19 May 2022	Conservative Political Action Conference Hungary
16 May 2022	Speech given by Prime Minister after swearing his prime ministerial oath
19 February 2023	State of the Nation
4 May 2023	Conservative Political Action Conference Hungary
22 July 2023	Bálványos Summer Free University and Student Camp
23 October 2024	68th Anniversary of the 1956 Hungarian Revolution and Freedom Fight
25 April 2024	Conservative Political Action Conference Hungary

Burimi: Të dhënat e autorit

Studimi i këtij koleksioni fjalimesh tregoi se Viktor Orbán pozicionohet vazhdimisht si mbrojtësi i Hungarisë kundër kërcënimeve të shkaktuara nga ndikimet e jashtme, duke përfshirë Bashkimin Evropian, organizatat joqeveritare dhe elitat globale. Në fjalimet e tij, ai thekson rëndësinë e sovranitetit kombëtar dhe i portretizon këta aktorë të jashtëm si burimet kryesore të sfidave ndaj Hungarisë, duke i paraqitur ata si kërcënues të vlerave, sigurisë dhe vetëvendosjes hungareze. Duke e paraqitur veprimtarinë e qeverisë së tij si një përgjigje të domosdoshme ndaj këtyre kërcënimeve të perceptuara, Orbán legjitimon në mënyrë efektive politikën e tij në emër të mbrojtjes së interesave të popullit dhe ruajtjes së vlerave tradicionale dhe pavarësisë së Hungarisë. Kjo qasje i lejon atij të fitojë mbështetje brenda vendit, duke e kontrastuar rrugën e Hungarisë me atë të Perëndimit liberal dhe progresiv.

Nëpërmjet një analize të shpeshtësisë së termave kyç në fjalimet e Viktor Orbán-it gjatë periudhës 2022–2024, Tabela 3 përmbledh analizën e frazave dhe temave kryesore që karakterizojnë narrativat e këtij lideri. Kjo analizë nxjerr në pah përdorimin e termave si “sovranitet kombëtar,” “marrëveshje të padrejta,” “interesat kombëtare,” dhe “mbrojtja e kulturës tradicionale,” të cilat përforcojnë diskursin populist të tij dhe krijojnë një ndarje të qartë midis “popullit të vërtetë” hungarez dhe aktorëve të jashtëm të perceptuar si kërcënues.

Në këtë mënyrë, strategjitë retorike të përdorura nga Orbán jo vetëm që theksojnë kërcënimet e jashtme, por gjithashtu ndërtojnë një ndjenjë të përbashkët të identitetit kombëtar dhe të rezistencës, duke nxitur më tej mbështetjen për qeverisjen e tij dhe politikën e tij populiste.


Tabela 3. Analiza e Frekuencës së Termave Kryesore në Fjalimet e Viktor Orbán-it

Termi/tematika	Frekuenca (%)	Kontenti në fjalim
Western world/civilization/values	0,09	Refers to West that dominated by progressive ideologies, secularism, and liberal elites pushing multiculturalism and globalization, which he views as threats to national sovereignty and traditional values.
Economic Stability/Isolation	0,04	References to economic policies protecting jobs, combating inflation, and prioritizing the Hungarian economy.
Christianity/Christian	0,05	Presents Hungary as a defender of Christian Europe, stressing the importance of preserving Christian culture and values against perceived external threats.
Left/Liberal	0,1	The liberal establishment portrayed as out of touch with the real concerns of ordinary citizens, imposing top-down policies and supporting values like multiculturalism, LGBTQ rights, and economic austerity measures that, according to Orbán, erode national sovereignty and traditional values

Burimi: Të dhënat e autorit

Figura 1 ilustron ndryshimet në frekuencën e temave kryesore në fjalimet e Viktor Orbán-it nga viti 2020 deri në 2024. Kjo vizualizim ndihmon në kuptimin e dinamikës së theksimeve në retorikën e Orbán-it, në varësi të kontekstit politik dhe shoqëror.

Figura 1. Frekuenca e Termave Kryesore në Fjalimet e Viktor Orbán-it Gjatë Kohës



Burimi: Të dhënat e autorit


Figura 2 paraqet dinamikën e mbështetjes publike për partinë Fidesz, të udhëhequr nga Viktor Orbán, gjatë viteve 2020–2024. Të dhënat bazohen në analiza të sondazheve sociologjike të kryera në periudha të ndryshme, duke reflektuar ndryshimet në nivelin e mbështetjes për partinë ndër votues. Kjo dinamikë tregon qartë një korrelacion midis ndryshimeve në retorikën e Orbán-it dhe niveleve të mbështetjes.

Rritja e mbështetjes gjatë viteve 2020–2021 lidhet me theksimin e retorikës nacionaliste dhe kritikave ndaj vlerave liberale, të cilat gjetën jehonë tek elektorati hungarez. Për shembull, në vitin 2021, Orbán përdori në mënyrë aktive temat e "mbrojtjes së vlerave kristiane" dhe kundërshtimit të "ideologjive progresive perëndimore," çka konfirmohet nga të dhënat e Institutit Nézópont, sipas të cilave 55% e të anketuarve mbështetën partinë Fidesz (Instituti Nézópont, 2021).

Rënia e mbështetjes në vitin 2022, deri në 41%, shpjegohet me sfidat ekonomike, përfshirë inflacionin e lartë dhe presionin ndërkombëtar mbi qeverinë për shkak të pozicionit të saj ndaj BE-së. Në të njëjtën kohë, rritja e mbështetjes në vitin 2023 (në 51%) lidhet me fitoren e Orbán-it në zgjedhjet parlamentare dhe aftësinë e tij për të mobilizuar elektoratin përmes retorikës antagoniste ndaj sanksioneve të BE-së dhe ruajtjes së sovranitetit kombëtar. Sipas një sondazhi nga Instituti Nézópont (2023), fushata e vitit 2023 ishte e fokusuar tek mbështetja e identitetit kombëtar, gjë që forcoi pozitën e tij.

Rënia në 37% në vitin 2024 demonstroi se popullariteti i Fidesz-it ka rënë ndjeshëm për shkak të humbjes së besimit të votuesve. Arsyet kryesore përfshinin rritjen e skandaleve të korrupsionit, përkeqësimin e paqëndrueshmërisë ekonomike dhe shfaqjen e një force të re opozitare, partisë Tisza, e cila, sipas Reuters (2024), mori 42% të votave, duke kaluar për herë të parë Fidesz-in në renditje. Këto zhvillime theksojnë peizazhin politik në ndryshim në Hungari.

Figura 2. Dinamika e mbështetjes publike për partinë Fidesz, të udhëhequr nga Viktor Orbán, gjatë viteve 2020–2024



Burimi: Telex.hu (2020), Nézőpont Institute (2021), Euronews (2022), Hungarian Conservative (2023), Reuters (2024).

Fjalimet e Orbánit gjithashtu vendosin një theks të rëndësishëm në teknikën populiste të "we-feeling", e cila ndihmon në krijimin e një ndjenje uniteti dhe solidariteti midis qeverisë dhe popullit. Ai shpesh përdor përemrat "ne", "tonë" për të krijuar një ndjenje komuniteti kolektiv, ku të gjithë hungarezët janë pjesë e një "ne"-je, dhe gjithashtu krijon një bazë për konsolidimin kundër "armiqve të përbashkët". Kjo i mundëson të forcojë idenë e një beteje të përbashkët dhe përgjegjësisë së ndarë për të ardhmen e kombit.

Narendra Modi ka përdorur me sukses teknikën "we-feeling" si një element qendror të retorikës së tij populiste, e cila bazohet në idetë e trashëgimisë kulturore indiane dhe krenarisë historike. Qasja e tij përfshinte përdorimin e tregimeve fetare dhe nacionaliste që synonin krijimin e një ndjenje uniteti mes qytetarëve, veçanërisht duke theksuar rëndësinë e hinduizmit si baza e identitetit kombëtar (Academics, S. B. 2023). Gjatë fushatës së tij në vitin 2014, Modi përdori aktivisht konceptin e "Modelit Gujarat", i cili paraqiste rritjen ekonomike dhe zhvillimin e rajonit si rezultat i qeverisjes së tij (Akhtar, R. 2024). Kjo i mundësoi të krijonte një imazh të një "njeriu të fortë" – një lider që është i aftë të zgjidhë problemet ekonomike dhe sociale të Indisë.

Retorika e Modit e dallon qartë mes "indianëve të vërtetë", të cilët ai i përshkruan si besnikë ndaj vlerave tradicionale, dhe "armikëve të shtetit", mes të cilëve ai veçon myslimanët dhe grupe të tjera fetare dhe etnike. Gjatë një tubimi elektorale më 21 prill 2024, në shtetin e Rajasthan, Kryeministri indian Narendra Modi i quajti myslimanët "infiltrues" dhe deklaroi se partia opozitare Kongresi, kur të vijë në pushtet, do të shpërndante pasuritë kombëtare mes "ata që kanë më shumë fëmijë" – një aludim ndaj komunitetit mysliman (Al Jazeera, 2024). Këto komente shkaktuan zemërim dhe akuza për nxitje të urrejtjes fetare. Partia opozitare Kongresi ngriti një ankesë formale me Komisionin e Zgjedhjeve të Indisë, duke e akuzuar Modin për përdorimin e fjalorit të urrejtjes dhe shkelje të kodit zgjedhor, i cili ndalon kandidatët të nxisin tensione fetare.

Modi gjithashtu ka përdorur aktivisht simbole fetare, si ndërtimi i tempullit Ram në Ayodhya, për të forcuar lidhjen e tij me shumicën hindu të vendit. Këto veprime e kanë forcuar pozitat e tij si "Hindu Hriday Samrat" – "Perandori i zemrave hindu" (Jaffrelot, C. 2021). Njëkohësisht, politikën e tij ekonomike, duke përfshirë programet "Make in India" dhe "Digital India", synojnë të krijojnë një imazh të Indisë si një shtet modern dhe të vetëqëndrueshëm me një vend në ekonominë globale (Hitchen, G., et al. 2023). Retorika e Modit kombinon elemente të nacionalizmit, fesë dhe zhvillimit ekonomik, duke krijuar një "ndjenje ne-ndjesie" unike që mobilizon elektoratin e tij, duke thelluar ndarjet socio-politike në vend. Kjo qasje i mundëson atij të mbajë pushtetin pavarësisht sfidave si

kriza ekonomike ose protestat e fermerëve, duke e pozicionuar veten si liderin e vetëm të aftë të sigurojë të ardhmen e Indisë.

Recep Tayyip Erdoğan gjithashtu përdor retorikën populiste për të mobilizuar mbështetje dhe justifikuar sundimin e tij, veçanërisht pas tentativës për grusht shteti në vitin 2016. Thelbi i strategjisë së tij politike është koncepti i një "Turqie të re", i cili synon të rikthejë madhësinë historike, të forcojë identitetin islamik dhe të ndërpresë ndikimin perëndimor. Ky koncept thekson krenarinë kombëtare dhe rilindjen shpirtërore, duke krijuar një dallim të qartë mes "popullit të pastër turk" dhe "elitave të korruptuara" ose "armikëve të jashtëm" (Canveren, O., & Kaiser, A. 2024).

Pas tentativës për grusht shteti të vitit 2016, Erdogan nisi një pastrim të gjerë që goditi gjyqësorin, median, institucionet arsimore dhe ushtrinë. Ai akuzoi lëvizjen Hizmet dhe liderin e saj, Fethullah Gülen, për komplot kundër shtetit, duke përdorur ngjarjet për të justifikuar një sulm dhe centralizim të pushtetit (Rogenhofer, J. M. 2018). Rretorika e tij shpesh thekson ekzistencën e komplotesh nga ana e Perëndimit dhe Bashkimit Evropian, të cilët i akuzon se mbështesin terroristët dhe për dyfishtë standarde ndaj Turqisë (Aras, Ü. E. 2023).

Erdogan ka përdorur gjithashtu historinë e Perandorisë Osmane si një burim frymëzimi. Ai ka theksuar arritjet historike, si periudha e Sulejman Magnificentit, për të legjitimuar vizionin e tij për një "Turqi të fortë" që po rimerr ndikimin në rajon dhe në botë. Ai ka përdorur gjithashtu simbole fetare, përfshirë hapjen e xhamive të reja dhe konvertimin e Hagia Sofisë në xhami, për të forcuar mbështetjen nga votuesit konservatorë dhe fetarë (Tepe, S., & Chekirova, A. 2022).

Në politikën e jashtme, Erdogan ka adoptuar qasje populiste bazuar në retorikë anti-Perëndimore dhe theksimin e sovranitetit turk. Strategjitë e tij përfshijnë personalizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, duke theksuar marrëveshjet dypalëshe që anashkalojnë institucionet shumëpalëshe si BE (Taş, H. 2022). Rretorika e tij gjithashtu pozicionon Turqinë si "mbrojtës të muslimanëve të shtypur", që kontribuon në imazhin e një lideri që përfaqëson "vullnetin e popullit."

Megjithatë, kjo retorikë kontribuon në polarizimin e shoqërisë turke. Sekularistët, minoritetet etnike, veçanërisht kurdët, dhe kundërshtarët politikë po marginalizohen gjithnjë e më shumë. Kjo i mundëson Erdoganit të forcojë mbështetjen nga baza e tij, por njëkohësisht krijon rreziqe afatgjata për unitetin e vendit (Cagaptay, S. 2019).

Marine Le Pen përdori një teknikë të apelimit ndaj popullit përmes "we-feeling" duke përdorur kujtesën kolektive. Duke përdorur imazhe historike dhe duke evokuar kujtesën kolektive të francezëve, Le Pen krijoi te votuesit një ndjenjë uniteti kombëtar dhe mbrojtjeje nga kërcënimet e jashtme.

Ndër elementët kryesorë të rretorikës së Marine Le Pen janë referencat ndaj imazheve të "epokës së artë" të Francës, koncepti i unitetit kombëtar dhe heronjve historikë si Jeanne d'Arc. Këto apeline ndaj ngjarjeve historike ndihmojnë në krijimin te votuesit të një ndjenje "we-feeling", mbi të

cilën Le Pen propozon vizionin e saj për të ardhmen e Francës, duke kërkuar kufizimin e imigracionit dhe ruajtjen e identitetit kombëtar (Soffer, D. 2022).

Kjo qasje thekson se ka një "ne" – të pastër, të drejtë, të vërtetë – dhe një "ata" – forca të jashtme ose armiq të brendshëm që pengojnë realizimin e qëllimeve dhe ideali të përbashkëta. "We-feeling" kontribuon në faktin që qytetarët fillojnë të identifikohen me një grup të homogjenizuar, që rrethohet ose sulmohet nga "të tjerë" me vlera, interesa ose qëllime kundërshtarë. Kështu, krijohet një imazh i një kombi ose komuniteti të vetëm, i cili mbron veten nga kërcënimet nga jashtë ose nga "tradhtarët" brenda vendit.

Kjo teknikë kontribuon ndjeshëm në polarizimin e shoqërisë, pasi ndan qartë vijën mes "nesh" dhe "atyre". Rretorika e "we-feeling" intensifikon ndjenjat e opozitës, duke thelluar konfliktin dhe duke theksuar idenë se "ne" duhet të luftojmë për të drejtat tona, tokën tonë ose vlerat tona.

Ndërsa forcon ndjenjën e unitetit, liderët populistë gjithashtu theksojnë dallimet mes "popullit të zakonshëm" dhe "elitës" që supozohet se kanë humbur lidhjen me "popullin e vërtetë" dhe punojnë vetëm për vete ose për interesa të jashtme. Kjo thellon edhe më shumë polarizimin, duke bërë që rretorika të bëhet më agresive dhe ndarjet shoqërore dhe politike të thellohen. Si rezultat, "we-feeling" bëhet baza për mobilizimin emocional të qytetarëve dhe është një mjet efektiv për të ndarë shoqërinë në dy kampe armiqësore që ushqehen nga mosbesimi dhe refuzimi i ndërsjellë.

Donald Trump është i njohur për rretorikën e tij polarizuese gjatë fushatave zgjedhore, e cila jo vetëm që tërheq vëmendjen publike, por gjithashtu ndan shoqërinë në grupe të kundërta. Në korpusin e studiuar të fjalimeve para zgjedhjeve të SHBA-ve të vitit 2016 (Tabela 4), theksi është tek "ne" dhe "ata", duke krijuar një imazh të armiqve të jashtëm ose të brendshëm që kërcënojnë "amerikanët e vërtetë". Në diskursin e tij, "ne" përfshin patriotat të vërtetë, njerëz që mbështesin vlerat tradicionale amerikane, si dhe ata që ndjekin idealet konservatore. Këtu përfshihen përfaqësues të Partisë Demokratike, liberalët, emigrantët myslimanë dhe grupe të tjera që, sipas Trump-it, kërcënojnë unitetin dhe sigurinë e vendit.

Tabela 4. Përmbledhje e fjalimeve të Donald Trump

Data	Speech Occasion
16 June 2015	Remarks Announcing Candidacy for President in New York City
21 March 2016	Remarks at the AIPAC Policy Conference in Washington, DC
27 April 2016	Remarks on Foreign Policy at the National Press Club in Washington, DC
22 June 2016	Remarks at Trump SoHo in New York City
5 August 2016	Remarks at the KI Convention Center in Green Bay, Wisconsin

Data	Speech Occasion
15 August 2016	Donald Trump Addresses Radical Islamic Terrorism
15 August 2016	Remarks at Youngstown State University in Youngstown, Ohio
19 August 2016	Remarks at the Summit Sports and Ice Complex in Dimondale, Michigan
10 March 2016	Donald Trump: 'I Think Islam Hates Us'

Burimi: Të dhënat e autorit

Një komponent kyç i retorikës polarizuese të Trump-it është theksi i tij mbi kërcënimet e jashtme dhe të brendshme. Në fjalimet e tij, ai përdor terma hiperbolikë dhe fraza të ngarkuara emocionalisht për të nxitur frikë ose emocione të tjera. Trump-i i paraqet grupe të ndryshme etnike ose sociale si kërcënime për punët, sigurinë dhe kulturën amerikane, duke i dhënë elektoratit të tij ndjenjën se jetët e tyre janë në rrezik dhe se vetëm udhëheqja e tij mund t'i mbrojë ata.

Gjatë zgjedhjeve të vitit 2016, Trump gjithashtu përdori aktivisht imazhe negative kundër kundërshtarëve të tij politikë, veçanërisht kundër kandidatëve demokratë si Barack Obama dhe Hillary Clinton. Ai i paraqiti ata si të dobët, të paafte ose tradhtarë që i vënë interesat e tyre personale mbi interesat e vendit. Kjo ndarje e qartë në “liberalë të këqij” dhe “patriotë konservatorë të drejtë” i dha Trump-it mundësinë të forconte ndjenjat e besnikërisë të mbështetësit të tij dhe të konsolidojë imazhin e një “armiku” që kërcënonte interesat kombëtare.

Rretorika polarizuese e Trump-it ka krijuar një ndjenjë të vazhdueshme krize, ku Amerika, sipas tij, po lufton për mbijetesën e saj. Ai ka deklaruar shumë herë se vetëm politikën e tij mund të garantojnë sigurinë dhe prosperitetin e vendit, duke e forcuar retorikën e tij me ide për madhështinë e Amerikës dhe ringjalljen e saj. Ky qasje ka shkaktuar jo vetëm ndarje të mëdha shoqërore, por ka kontribuar gjithashtu në faktin se diskursi publik është bërë gjithnjë e më i ndarë dhe i mbushur me mosbesim midis grupeve të ndryshme të popullsisë.

Tabela 5 tregon diskursin polarizues dhe ndarës që Donald Trump ka përdorur, duke kategorizuar grupe dhe individë si pjesë të një strategjie retorike për të krijuar grupe të qarta "të brendshme" dhe "të jashtme". Ky qasje është në përputhje me retorikën populiste, e cila kërkon të dallojë një “ne” moralisht superior nga një “ata” kërcënues ose të korruptuar.

Tabela 5. Diskursi polarizues i Trump (US or SELVES and THEM or OTHERS)

US (SELVES)		THEM (OTHERS)	
Christians	Good, positive, innocent, peaceful, targeted, wise, persecuted, and victims	Muslims	Bad, negative, terrorists, violent, peace-haters, spiteful, murderers, vengeful, evil, enemy
Israel	Ally	Iran	Enemy
Native Americans	Poor, marginalized, stolen rights, deceived, powerless, unimportant, and neglected	Immigrants and Refuges	Ascendant, dominant, important, powerful, dangerous, evil, destructive, deceptive
Trump	Good, positive, compassionate, sympathetic, wise, equitable, respectful, understandable, reformer	Obama and Clinton	Bad, negative, wrong, reckless, thoughtless, careless, false, weak, disastrous, rudderless, aimless, senseless, destructive

Burimi: Kadim, E. N. 2022

Në gjuhën e Trump-it, krishterët, Izraeli, amerikanët vendas dhe vetë ai janë vendosur në një kategori “NE” të lidhur me përshtime jashtëzakonisht pozitive. Për shembull, krishterët quhen “të mirë,” “pozitivë,” “të pafajshëm,” “paqësorë” dhe “viktima,” duke i paraqitur ata si të drejtë dhe nën kërcënim, që ngjall simpatinë dhe solidaritetin te audienca e tij. Ky narrativ krijon një imazh të krishterëve si të persekutuar, të synuar nga forca të jashtme dhe, prandaj, të merituar për mbrojtje. Po ashtu, Izraeli paraqitet si një aleat, duke theksuar solidaritetin dhe vlerat e përbashkëta kundër armikëve të përbashkët. Në kontrast, kategoria “ATA” përfshin myslimanët, Iranin, emigrantët dhe refugjatët, si dhe kundërshtarët politikë, të cilët përshkruhen me terma të ashpër negativë. Myslmanët, në veçanti, janë të izoluar me përshtime si “terroristë,” “të dhunshëm” dhe “armiq,” që forcojnë më tej stereotipat që lidhin Islamin me ekstremizmin dhe pozicionojnë myslimanët si një kërcënim të drejtpërdrejtë për krishterët “të pafajshëm” dhe “paqësorë.” Ky taktizëm shfrytëzon frikën dhe paragjykimin, duke parë myslimanët si “të tjerë” të rrezikshëm që janë në kundërshtim të drejtpërdrejtë me vlerat amerikane dhe krishtere. Po ashtu, Irani etiketuar si “armik,” duke e bashkuar me një narrativë më të gjerë kundër aleatëve të SHBA-së si Izraeli, duke polarizuar më tej audiencën dhe forcuar ndarjen mes miqve të perceptuar dhe armiqve.



Nga intervistat cilësore, të dhënat zbulojnë një dimension emocional që nuk shfaqet plotësisht në analizat statistikore. Shumë respondentë reflektojnë se mesazhet populiste nxisin ndjenja të forta si zemërim, frikë dhe ndjenja e braktisjes. Një respondent theksoi: "Kur dëgjoj fjalë që tregojnë se institucionet janë të korruptuara dhe të larguara nga nevojat tona, ndjej se nuk kam asnjë vend ku të besoj." Këto deklaratat sugjerojnë se ndikimi i retorikës populiste nuk është vetëm një efekt numerik,

por përfshin një proces të thellë psikologjik dhe emocional që nxit një klimë të pashpresë dhe izolimi social. Këto rezultate cilësore i bashkëngjisin të dhënave statistikore për të formuluar një pamje gjithëpërfshirëse të ndikimit të retorikës.

Një tjetër dimension i rëndësishëm që nxirret nga intervistat është perceptimi i qytetarëve për "institucionet e shkëputura". Shumë respondentë përmendin se mesazhet që i paraqesin institucionet si të shkëputura nga nevojat e tyre ndikojnë në një ulje të besimit dhe nxisin një ndjenjë të humbjes së mundësive për përfaqësim të drejtë. Ky perceptim reflektohet edhe në rezultatet e anketave, ku një përqindje e madhe e respondentëve ndjehen se institucionet nuk i përfaqësojnë në mënyrë adekuate interesat dhe nevojat e tyre. Kjo vazhdimësi midis të dhënave anketare dhe intervistave mbështet rëndësinë e një integrimi metodologjik, i cili e forcon besueshmërinë e gjetjeve tona.

Në një krahasim midis variablave të ndryshëm, është evidentuar se faktorë të tjerë, si konsumimi i mediave alternative, gjithashtu ndihmojnë në shpjegimin e uljes së besimit. Të dhënat tregojnë se shqiptarët që marrin informacion kryesisht nga rrjetet sociale janë më të prirur të kenë një perceptim negativ ndaj institucioneve, duke reflektuar një efikasitet të mesazheve polarizuese që përhapet në këto platforma. Kjo tendencë është thelbësore për të kuptuar se ndikimi i retorikës nuk ndodh vetëm përmes fjalimeve politike, por edhe përmes mënyrës se si informacioni shpërndahet dhe konsumon në kohë reale në një mjedis dixhital.

Në vazhdim të analizës së integruar, ndikimi i retorikës populiste në uljen e besimit ndaj institucioneve demokratike në Shqipëri thellohet edhe më tej duke marrë në konsideratë disa dimensione të tjera, përfshirë ndikimin e faktorëve psiko-socialë dhe të mediave alternative. Në këtë pjesë të analizës, ne fokusohemi në rolin e mekanizmave të komunikimit dixhital dhe perceptimet e formuara përmes këtyre kanaleve, si dhe ndikimin e sfidave kulturore dhe historike në formësimin e besimit publik.

Një nga faktorët kryesorë që duhet theksuar është ndikimi i konsumit të mediave sociale në perceptimet e qytetarëve shqiptarë. Të dhënat tona anketare tregojnë se individët që marrin informacion kryesisht nga platforma dixhitale, si Facebook, Twitter dhe Instagram, janë më të prirur të kenë një perceptim negativ ndaj institucioneve demokratike. Ky efekt mund të shpjegohet nga mënyra se si mediat alternative shpërndajnë mesazhe polarizuese dhe ndërsjellin informacione të pa verifikuara, të cilat rrisin ndjenjën e zbrazësisë dhe mosbesimit. Në një analizë regressive të avancuar, variabli "konsumimi i mediave sociale" korrelohet pozitivisht me indeksin e mosbesimit, duke shtuar rreth 0.35 pikë në model, një vlerë që mbetet e rëndësishme edhe pas kontrollit të faktorëve demografikë. Këto rezultate sugjerojnë se në një mjedis dixhital, ku informacioni është i shumtë dhe shpesh i fragmentuar, retorika populiste mund të përforcojë një cikël negativ të perceptimeve, duke reduktuar besimin në institucione.

Nga ana cilësore, intervistat theksojnë se shumë qytetarë shqipëtarë përjetojnë një ndjenjë të thellë frustrimi për shkak të mungesës së transparencës në institucionet publike. Një respondent e përshkroi këtë situatë kështu: "Kur shohim se informacioni që na jep institucioni është i përkufizuar dhe i kontrolluar, dhe rrjetet sociale na mbushin me mesazhe që na ndajnë, ndjej se nuk ka asnjë vend ku të besojmë." Këto deklaratë reflektojnë një përvojë të përbashkët ku ndikimi i mesazheve polarizuese, të përhapura kryesisht në mjedise dixhitale, ka çuar në një fragmentim të perceptimeve kolektive dhe në uljen e besimit institucional.

Një tjetër faktor që duhet marrë parasysh është ndikimi i kontekstit historik dhe kulturor shqiptar. Historia politike e vendit, e cila përfshin periudha të ndryshme tranzicioni dhe sfidat në ndërtimin e institucioneve të forta demokratike, ka krijuar një klimë të përhershme skepticizmi ndaj institucioneve. Kjo trashëgimi historike bashkohet me përdorimin e gjuhës polarizuese nga udhëheqësit aktualë, duke përforcuar një narrativë ku institucionet konsiderohen si mjaft të dobëta dhe të mos besueshme. Të dhënat tona cilësore tregojnë se një numër i konsiderueshëm i qytetarëve e lidhin këtë ndjenjë skepticizmi me përvojat e tyre personale dhe me një perceptim të përgjithshëm se institucionet nuk janë në gjendje të adresojnë nevojat reale të popullit. Në këtë kontekst, retorika populiste, duke përdorur mesazhe të thjeshta dhe duke nxitur ndjenja emocionale, forcon kështu një klimë ku çdo përpjekje për reformë ose dialog duket si një tradhti ndaj interesave të përbashkëta.

Për të thelluar analizën tonë, kemi konsideruar edhe ndikimin e faktorëve socio-ekonomikë. Të dhënat statistikore tregojnë se në grupet më të prekura ekonomikisht, lidhja midis ekspozimit ndaj retorikës populiste dhe uljes së besimit është më e theksuar. Në zonat ku nivelet e papunësisë janë më të larta dhe ku burimet për zhvillim ekonomik janë të kufizuara, qytetarët janë më të prirur të ndjehen të zhgënjyer dhe të mos besojnë në institucionet publike. Kjo situatë lidhet ngushtë me përdorimin e mesazheve që përçojnë një narrativë të "popullit të pafuqishëm" kundrejt "elitës së privilegjuar", një strategji që nuk është vetëm retorike, por ka edhe një efekt të drejtpërdrejtë në perceptimin e realitetit ekonomik dhe social.

Në analizën tonë të integruar, modelet statistikore që përfshijnë variabla të tilla si ekspozimi ndaj mesazheve populiste, konsumimi i mediave alternative dhe faktorët socio-ekonomikë, përforcojnë një pamje të përbashkët: retorika populiste ka një ndikim destabilizues në besimin institucional. Kjo është thelbësore për të kuptuar pse një përjasje e integruar, që përfshin masa për përmirësimin e qasjes në informacion, trajnime për udhëheqësit politikë dhe reforma institucionale, është e domosdoshme për rikthimin e besimit publik në Shqipëri.

Në këtë kontekst, të dhënat anketare dhe intervistat reflektojnë një klimë të përhershme frustrimi dhe ndarje, ku retorika populiste kontribuon në një perceptim të përbashkët negativ ndaj institucioneve. Rezultatet e analizave tona sugjerojnë se si faktorë objektivë (p.sh., shkalla e ekspozimit ndaj mesazheve) ashtu edhe faktorë subjektivë (p.sh., përvojat personale dhe emocionale

të qytetarëve) bashkë ndikojnë në uljen e besimit institucional. Ky efekt dyfishtë, i matshëm me modelet statistikore dhe i përshkruar në detaje në intervistat cilësore, thekson rëndësinë e ndërhyrjeve të orientuara drejt komunikimit transparent dhe të bazuar në dialog, për të rivendosur një klimë të besimit dhe për të reduktuar ndarjet sociale.

Ndjeshmëria e segmenteve sociale ndaj retorikës populiste

Lëvizjet populiste kanë një aftësi të veçantë për të apeluar efektivisht tek grupe të ndryshme shoqërore duke shfrytëzuar emocione të thella, pakënaqësi dhe ndarje shoqërore ekzistuese. Duke u drejtuar tek përvoja dhe frustrimet bazë, populistët mund të bashkojnë segmente të ndryshme të popullatës nën një kauzë të përbashkët. Ky qasje i lejon individëve me pasaporta të ndryshme që mund të jenë zhgënjyer nga institucionet tradicionale të kërkojnë përgjigje të thjeshta për probleme shoqërore komplekse.


Përgjigjshmëria ndaj retorikës populiste ndryshon mes grupeve shoqërore, e ndikuar nga faktorë të tillë si statusi socio-ekonomik, niveli i arsimit, alienimi politik dhe identiteti kulturor. Individët me të ardhura më të ulëta ose ata që ndjejnë veten ekonomikisht të marginalizuar mund të jenë më të prirur për të pranuar premtimet populiste që ofrojnë ndryshime të shpejta dhe radikale. Ndërkohë, ata me nivele më të ulëta arsimit ose ata që mosbesojnë tek media tradicionale apo akademia mund të jenë më të hapur ndaj retorikës anti-elitariste që vë në pikëpyetje besueshmërinë e informacionit zyrtar. Po ashtu, alienimi politik, që është mungesa e besimit në aftësinë e institucioneve shtetërore për të përfaqësuar drejt interesat e tyre, rrit ndjeshmërinë ndaj narrativave populiste që vënë në dyshim mekanizmat tradicionale demokratikë. Për ata që ndjejnë humbje të identitetit kulturor përballë globalizimit ose migrimit të masave, populizmi ofron mbrojtje dhe kthim tek “vlerat tradicionale” dhe ruajtja e kulturës “autentike” kombëtare. Kështu, është e rëndësishme të kuptohet se si dhe pse narrativat populiste rezonojnë ndryshe mes grupeve të ndryshme të popullsisë. Kuptimi i këtyre nuancave mundëson një analizë më të thellë të ndikimit të populizmit në kohezionin shoqëror dhe opinionin publik, si dhe parashikimin e grupeve që janë më të ndjeshme ndaj këtij lloji të retorikës politike.

Pabarazia ekonomike shihet si një nga shtysat kryesore të mbështetjes për lëvizjet populiste. Rritja e pabarazisë mund të çojë në pasiguri ekonomike dhe çoroditje shoqërore, e cila nga ana e saj rrit mbështetjen për partitë populiste (Rodríguez-Pose, A., Terrero-Dávila, J., & Lee, N. 2023). Individët që ndihen ekonomikisht të pasigurtë ose të marginalizuar janë më të prirur të mbështesin populistët që premtojnë ndryshime radikale, shpërndarje të pasurisë dhe drejtësi ekonomike. Hulumtimi nga Lukas F. Stoetzer et al. (2023) tregon se në shoqëri me nivele të larta pabarazie, populistët përdorin vështirësitë socio-ekonomike për të mobilizuar mbështetje mes grupeve me të ardhura të ulëta. Në vitin 2013, Hugo Chávez fitoi mbështetje nga popullata e varfër të Venezuelës

duke premtuar shpërndarje të konsiderueshme të burimeve dhe drejtësi sociale. Administrata e tij realizoi programe të gjera sociale që kishin për qëllim lehtësimin e varfërisë dhe zgjerimin e qasjes në arsim dhe kujdes shëndetësor. Këto iniciativa u financuan duke nacionalizuar industritë kyçe dhe duke shpërndarë të ardhurat nga nafta. Megjithatë, pavarësisht këtyre përpjekjeve, varfëria dhe papunësia mbetën probleme serioze në Venezuelë (De la Torre, C. 2020). Sipas sondazheve, përqindja e të anketuarve që shprehën qëllimin për të votuar për Chávez ishte 48% në vitin 2013 (Nadeau, R., Bélanger, É., & Didier, T. 2013).

Në Evropë, mund të vihen re trende të ngjashme tek partitë populiste të majta, siç janë Podemos në Spanjë dhe Syriza në Greqi. Retorika dhe politikat e tyre kanë pasur fokus kritikën ndaj kapitalizmit neoliberal, të cilin ata e besojnë si shkakun e vështirësive ekonomike për popullatën në përgjithësi. Pas krizës financiare të vitit 2008, situata ekonomike në Spanjë është përkeqësuar ndjeshëm, duke çuar në një rritje të mprehtë të papunësisë tek të rinjtë. Sipas Bankës Botërore, niveli i papunësisë tek të rinjtë në Spanjë arriti në 55.48% në vitin 2013, niveli më i lartë në gjithë periudhën e vëzhgimit (Figura 16).

Figura 16. Të dhënat mbi papunësinë e të rinjve në Spanjë (%)



Burimi: World Bank Group. Unemployment, youth total (% of total labor force ages 15-24) (modeled ILO estimate) - Spain | Data

Podemos fitoi mbështetje të gjerë duke apeluar ndaj padrejtësisë shoqërore dhe duke kërkuar ndryshime radikale ekonomike. Në vitin 2015, partia Podemos shijoi mbështetje të konsiderueshme mes spanjollëve. Sipas një sondazhi të realizuar nga Metroscopia për gazetën El País në janar 2015, Podemos mori 28.2% të mbështetjes totale të votuesve, duke kaluar partitë tradicionale (Junquera, N. 2015).

Liderët populistë të krahut të djathtë shpesh përdorin retorikë ekonomike që thekson proteksionizmin dhe sloganet nacionaliste si një mjet për të zgjidhur problemet ekonomike. Në thelb të kësaj qasjeje është dëshira për të mbrojtur tregun e brendshëm nga ndikimi i jashtëm, për të forcuar sovranitetin e vendit dhe për të rimarrë kontrollin mbi ekonominë e tij. Një nga shembujt më të dukshëm të kësaj qasjeje ishte fushata për daljen e Mbretërisë së Bashkuar nga Bashkimi Evropian (Brexit), ku forca politike, përfshirë Partinë e Pavarësisë së Mbretërisë së Bashkuar (UKIP) dhe liderin e saj Nigel Farage, përdorën retorikë që premonte mbrojtjen e interesave ekonomike të popullit britanik duke dalë nga BE.

Gjatë fushatës për Brexit, Farage dhe populistë të tjerë të krahut të djathtë theksuan aktivisht se BE, me kufijtë e saj të hapur dhe lëvizjen e lirë të punëtorëve, ishte një kërcënim për ekonominë britanike dhe mirëqenien e qytetarëve të zakonshëm. Ata argumentuan se imigrimi i pakontrolluar nga vendet e BE-së çon në konkurrencë për vende pune, që dëmton kryesisht klasën punëtore britanike, e cila ndien presion mbi tregun e punës (Kırpıklı, S. 2023). Sipas Farage dhe bashkëpunëtorëve të tij, dalja nga BE do t'i mundësonte Mbretërisë së Bashkuar të vendoste kontroll më të ngushtë mbi kufijtë e saj, të kufizonte fluksin e punëtorëve të huaj dhe të sigurojë që qytetarët vendas të kishin prioritet në aksesimin e vendeve të punës.

Retorika e Brexit gjithashtu përfshinte pretime për rivendosjen e sovranitetit kombëtar, të cilin mbështetësit e daljes argumentonin se ishte humbur pjesërisht përmes anëtarësimit në BE (Westcott, N. 2020). Gjatë fushatës për Brexit, Nigel Farage dhe populistë të tjerë të krahut të djathtë argumentuan se politikat e Bashkimit Evropian për kufijtë e hapur dhe lëvizjen e lirë të punëtorëve paraqisnin një kërcënim për ekonominë britanike dhe mirëqenien e qytetarëve të zakonshëm. Farage argumentoi se emigrimi masiv, i mundësuar nga anëtarësimi në BE, kishte bërë disa pjesë të Mbretërisë të “pashpërbajshme” dhe se dalja nga BE do t'i mundësonte Britanisë të rimerrte kontrollin mbi kufijtë e saj dhe të mbrojë vendet e punës brenda shtetit (BBC, 2014). Kjo retorikë rezonoi me votuesit që ishin të shqetësuar për imigracionin dhe stabilitetin ekonomik, duke kontribuar në mbështetje për Brexit. Kjo ishte veçanërisht e dukshme në sloganin “Merrni kontrollin prapë”, i cili u bë një nga simbolët e fushatës, duke theksuar rivendosjen e pavarësisë në administratën e vendit (Rigby, B. 2023).


Sondazhet e opinionit kanë treguar vazhdimisht se çështjet ekonomike dhe imigracioni ishin çelësi i mbështetjes për Brexit. Një sondazh i 2016 nga Observer gjeti (Figura 17) se 53% e britanikëve e identifikuan emigracionin si çështjen më të rëndësishme që po e ndikonte Mbretërinë e Bashkuar në periudhën para referendumit të BE-së, duke kaluar çështje të tjera si shëndetësia dhe Shërbimi Shëndetësor Kombëtar. Për më tepër, një sondazh nga Pew Research Center në vitin 2016 gjeti se 70% e mbështetësve të Leave ishin të pakënaqur me mënyrën se si Brukseli po e trajtonte

krizën e refugjatëve, dhe 55% ishin të pakënaqur me qasjen e BE-së ndaj problemeve ekonomike të Europës (Manevich, D. 2016).

Mbështetje për daljen nga BE ishte veçanërisht e fortë mes klasës punëtore me arsim të ulët, e cila ndiente kërcënim më të madh nga globalizimi dhe migrimi. Ata e shihnin daljen nga BE si mundësi për të siguruar kontroll më të mirë mbi tregun e brendshëm të punës dhe për të mbrojtur stabilitetin e tyre ekonomik.

Një nga elementët e rëndësishëm të kësaj fushate ishte çështja e financimit për Shërbimin Shëndetësor Kombëtar (NHS). Mbështetësit e Brexit, përfshirë Boris Johnson, argumentuan se dalja nga BE do të mundësonte që kontributi javor për buxhetin e BE-së të redirektohej për të mbështetur NHS-në (Burton, M. 2021). Ky argument apelonte tek drejtësia shoqërore dhe mbrojtja e burimeve të brendshme, që rezonoi me popullatën, veçanërisht mes atyre që besonin se paratë ishin më mirë të investoheshin në nevojat kombëtare, sesa në struktura supranacionale. Fushata për Brexit kështu kombinoi proteksionizmin ekonomik me retorikë nacionaliste, duke krijuar një imazh të mbrojtësve të sovranitetit britanik, që luftonin për interesat e qytetarëve të zakonshëm kundër “kontrollit të huaj” dhe presionit të jashtëm.

Figura 17. Cilat tre faktorë do të ndikojnë më shumë në mënyrën se si do të votoni në referendumin?




Burimi: Britons and Europe: the survey results | Brexit | The Guardian

Kështu, populistët e djathtë në Mbretërinë e Bashkuar ishin në gjendje të mobilizonin një pjesë të rëndësishme të popullatës duke përdorur një retorikë ekonomike që kishte për qëllim mbrojtjen e interesave kombëtare nga kërcënimet e jashtme. Mesazhet e tyre ishin të ndërtuara mbi një kombinim të proteksionizmit, retorikës anti-imigracion dhe premtimeve për pavarësi ekonomike, të cilat bindën shumë britanikë se largimi nga BE-ja ishte mënyra e vetme për të ruajtur mirëqenien ekonomike të vendit dhe identitetin kombëtar.

Kështu, pabarazia ekonomike, veçanërisht në një kontekst tensionesh sociale dhe kulturore, bëhet një faktor i fuqishëm në mbështetje të lëvizjeve populiste. Populistët e majtë fokusohen në shpërndarjen e pasurisë dhe drejtësinë sociale, ndërsa populistët e djathtë fokusohen në mbrojtjen e ekonomisë kombëtare dhe kufizimin e ndikimeve të jashtme, përfshirë emigracionin.

Niveli i arsimit është një tjetër faktor kyç në ndjeshmërinë ndaj retorikës populiste. Një studim i bërë nga van Slageren, J. dhe Rooduijn, M. (2023) tregoi se njerëzit me nivele më të ulëta arsimit kanë tendencë të jenë më të prirur ndaj mesazheve të thjeshta dhe të ngarkuara emocionalisht që karakterizojnë diskursin populist. Kjo është sepse nivelet më të ulëta të arsimit janë të lidhura me akses të kufizuar në perspektiva të ndryshme dhe një kapacitet të kufizuar për analizë kritike. Retorika populiste, me theksin e saj në dikotominë morale bardhë e zi dhe denigrimin e elitave, ofron shpjegime të thjeshta për çështje komplekse, duke e bërë atë më të aksesueshme për ata që kanë njohuri të kufizuara politike. Një shembull i qartë i lidhjes mes nivelit të arsimit dhe ndjeshmërisë ndaj retorikës populiste mund të shihet në referendumin për Brexit në vitin 2016 në Mbretërinë e Bashkuar. Një anketë e opinionit publik tregoi se 68% e atyre me nivele më të ulëta arsimit votuan për largimin nga Bashkimi Evropian (Figura 18).

Figura 18. Ndikimi i moshës, gjinisë dhe nivelit të arsimit në mbështetje për dobësimin e BE-së ndër Britanikë-t.



Ky model reflekton se si nivelet më të ulëta të arsimimit mund të lidhen me ndjeshmërinë ndaj ideve populiste, të cilat në rastin e Brexit theksonin sovranitetin kombëtar, sentimentet anti-elitiste dhe zgjidhje të thjeshta për çështje komplekse si emigracioni dhe autonomia ekonomike. Fushata për të lënë Bashkimin European, e cila paraqiste BE-në si një institucion të largët, jodemokratik, përgjegjës për humbjen e vendeve të punës dhe ndryshimet shoqërore, rezonoi fuqishëm me votuesit me kualifikime të ulëta arsimore. Ky grup shpesh kishte më pak mundësi për të pasur akses në perspektiva të ndryshme dhe ishte më i ndikuar nga mesazhet e fushatës që ngarkoheshin emocionalisht, të cilat e paraqisnin lënien e BE-së si një zgjidhje të thjeshtë për problemet brenda vendit. Arsimi është i lidhur me mundësinë për të pasur akses në burime të ndryshme informacioni, që është e rëndësishme për të formuar një vizion më objektiv të situatës politike. Njerëzit me nivele më të larta arsimimi janë më të njohur me pozita politike absolute, kanë një nivel më të lartë të mendimit kritik dhe, për këtë arsye, janë më pak të prirur për të pranuar skema të thjeshta (Aars, J., Christensen, D.A. 2020). Njerëzit me nivele më të larta arsimimi kanë tendencë të konsumojnë një gamë më të gjerë burimesh mediatike dhe ka më shumë mundësi të hasin pikëpamje të ndryshme politike, që mund të nxisin një vizion më objektiv të situatave politike. Individët me arsimin universitar kishin mundësinë të vlerësonin në mënyrë kritike mesazhet politike dhe, për këtë arsye, ishin më pak të prirur për të pranuar narrativat populiste të thjeshta. Arsimi i lartë inkurajon një kuptim të ndërvarësive komplekse, si ato që gjenden brenda sistemeve ekonomike dhe politike, të cilat i bëjnë individët më të kujdesshëm ndaj mesazheve që ofrojnë "zgjidhje të shpejta" për probleme të thella.

Për të shqyrtuar drejtpërdrejt fenomenin e ndjeshmërisë ndaj retorikës populiste mes grupeve demografikë, ky studim përfshiu një anketë të detajuar me 985 pjesëmarrës (Shtojca 1). Shpërndarja demografike u përqendrua posaçërisht në nivelin e arsimit dhe përfshinte 36.3% me diplomë të shkollës së mesme, 27.2% me disa vite kolegji pa diplomë, 14.3% me diplomë profesionale, 12.9% me diplomë bachelor dhe 9.3% me diplomë master.

Pjesëmarrësit u kërkuan të zgjidhnin një deklaratë që i përshtatej më mirë preferencave të tyre nga disa deklaratat për të vlerësuar nivelin e tyre të gatishmërisë për të pranuar mesazhe populiste:

1. "Një lider i fortë është i nevojshëm për të rikthyer rendin, edhe nëse ai shkel ligjin."
2. "Politikanët duhet të realizojnë vullnetin e popullit, edhe nëse kjo do të thotë të anashkalojnë disa norma demokratike."
3. "Premtimet e liderëve politikë për ndryshime të shpejta zakonisht nuk çojnë në rezultate afatgjata."
4. "Normat demokratike duhet të respektohen gjithmonë, edhe nëse ngadalësojnë progresin."

Analiza e të dhënave tregon një ndarje të konsiderueshme të preferencave politike të pjesëmarrësve:

Deklarata e zgjedhur	Nr pjesëmarrësve	Përqindja (%)
Një lider i fortë mbi ligjin	260	26.4%
Vullneti i popullit mbi normat demokratike	280	28.4%
Skepticizëm ndaj premtimeve populiste	200	20.3%
Mbështetje e normave demokratike	245	24.9%
Totali	985	100%

Burimi: Të dhënat e autorit

Të dhënat tregojnë se 54.8% e pjesëmarrësve kanë një prirje për të mbështetur narrativa populiste, ndërsa 45.2% janë më kritikë ose mbështetës të institucioneve demokratike. Kjo shpërndarje sugjeron se populizmi ka një ndikim të konsiderueshëm në perceptimet politike të qytetarëve, me më shumë se gjysmën e tyre që janë të gatshëm të mbështesin një qasje politike ku liderët mund të anashkalojnë normat demokratike në emër të stabilitetit ose të vullnetit të popullit. Rezultatet e anketës zbulojnë disa prirje të rëndësishme mbi ndjeshmërinë e grupeve të ndryshme ndaj mesazheve populiste. *Prirja për të mbështetur një lider të fortë dhe të pakontestueshëm:* Një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve (26.4%) beson se një lider i fuqishëm mund të rikthejë rendin, edhe nëse ai shkel ligjin. Kjo qasje është veçanërisht e theksuar në mesin e individëve me nivel më të ulët arsimor dhe atyre që kanë perceptime negative ndaj institucioneve demokratike. Në këtë kontekst, mungesa e besimit tek institucionet i shtyn qytetarët të kërkojnë zgjidhje të shpejta dhe lidërsip autoritar si alternativë ndaj një sistemi që konsiderohet i ngadalshëm dhe joefektiv. *Mbështetja për tejkalimin e normave demokratike për hir të popullit:* Me 28.4% të pjesëmarrësve që zgjedhin këtë option, vihet re një gatishmëri për të mbështetur qeverisjen në formë populiste, ku vullneti i popullit shikohet si më i rëndësishëm sesa procedurat institucionale. Kjo ndjenjë është më e përhapur tek ata që ndihen të përjashtuar nga proceset demokratike ose që perceptojnë një hendek midis elitave politike dhe qytetarëve të zakonshëm. *Skepticizmi ndaj premtimeve populiste:* Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve (20.3%) është e vetëdijshme për rreziqet e qasjes populiste dhe për tendencën e saj për të ofruar zgjidhje të thjeshtuara për probleme komplekse. Këta pjesëmarrës tregojnë një prirje për të kundërshtuar politikanët që premtojnë ndryshime të menjëhershme pa një bazë reale. *Përkrahja për normat demokratike edhe nëse ato ngadalësojnë procesin politik:* Me 24.9% të pjesëmarrësve që zgjedhin këtë option, rezulton se një pjesë e madhe e qytetarëve e shohin sundimin e ligjit dhe proceset demokratike si shtylla të rëndësishme të qeverisjes. Ky grup është më i përqendruar tek individët me arsim më të lartë dhe ata që kanë më shumë besim në institucionet demokratike.

Rezultatet e kësaj analize tregojnë qartë se populizmi nuk është një fenomen kalimtar apo i izoluar, por përkundrazi, ai është i rrënjësor thellë në perceptimet politike të një pjese të konsiderueshme të qytetarëve. Tendenca për të mbështetur një lider të fortë ose për të pranuar shmangien e normave demokratike në emër të vullnetit të popullit reflekton një dëshirë për vendimmarrje të shpejtë dhe të pakufizuar nga rregullat institucionale. Kjo prirje është veçanërisht e dukshme në mesin e individëve që e perceptojnë sistemin si joefektiv, të ngadaltë apo të ndikuar nga korrupsioni. Për pasojë, populizmi shfaqet jo vetëm si një strategji politike e përdorur nga liderët, por si një pasojë e drejtpërdrejtë e krizës së besimit në institucionet demokratike.

Një nga aspektet më të rëndësishme të këtyre gjetjeve është se mbështetja për populizmin nuk është e përhapur në mënyrë të barabartë në të gjitha segmentet e shoqërisë. Analiza tregon se ata që kanë një nivel më të lartë arsimimi janë më të prirur të refuzojnë mesazhet populiste dhe të mbështesin normat demokratike, ndërsa individët me arsim më të ulët dhe ata që ndihen të përjashtuar nga proceset politike shfaqin një tendencë më të madhe për të pranuar narrativa që sfidojnë rregullat demokratike. Kjo sugjeron se edukimi politik dhe informimi i saktë mbi funksionimin e institucioneve janë faktorë kyç për të reduktuar ndjeshmërinë ndaj populizmit. Në këtë kontekst, politikat publike që synojnë fuqizimin e qytetarëve përmes edukimit të tyre mbi proceset demokratike mund të shërbejnë si një mekanizëm mbrojtës ndaj rritjes së populizmit në të ardhmen.

Një tjetër aspekt kritik që del nga kjo analizë është se populizmi nuk shfaqet në vakum, por është një përgjigje ndaj perceptimit të krizës dhe keqfunksionimit të sistemit demokratik. Njerëzit që perceptojnë institucionet si të korruptuara dhe të paafta për të përfaqësuar interesat e tyre kanë më shumë gjasa të kërkojnë alternativa radikale, si lidërshtipi i fortë apo shmangia e disa procedurave demokratike në emër të efikasitetit. Kjo tregon se sfida e vërtetë për demokracinë nuk është vetëm përballja me populizmin si fenomen politik, por adresimi i shkaqeve të tij rrënjësore, si korrupsioni, mungesa e përfaqësimit dhe ndjenja e përjashtimit politik të qytetarëve.


Një element tjetër që vlen të theksohet është se narrativat populiste shpesh mbështeten nga mungesa e informacionit të besueshëm ose nga burime informacioni të cilat amplifikojnë mesazhe polarizuese. Në këtë kuptim, mënyra sesi qytetarët informohen dhe perceptojnë realitetin politik ndikon ndjeshëm në prirjet e tyre për të mbështetur ose refuzuar mesazhet populiste. Nëse burimet e informacionit janë të dominuara nga diskurse polarizuese ose të pasakta, individët janë më të prirur të bien pre e thjeshtësimeve politike dhe premtimeve për zgjidhje të shpejta. Kjo sugjeron se forcimi i gazetarisë investigative, promovimi i edukimit mediatic dhe sigurimi i një diskursi politik të bazuar në fakte janë strategji të rëndësishme për të reduktuar ndikimin e populizmit në diskursin publik.

Përfundimisht, këto rezultate theksojnë se populizmi nuk duhet parë thjesht si një problem politik që vjen nga liderët që e përdorin atë si strategji elektorale, por si një tregues i dobësive strukturore të demokracisë. Në vend që të fokusohemi vetëm në luftimin e populizmit si një fenomen

në vetvete, duhet të adresojmë pyetjen më themelore: përse një pjesë kaq e madhe e qytetarëve ndihen të zhgënjyer nga demokracia dhe të prirur të kërkojnë alternativa që sfidojnë parimet e saj? Kjo analizë sugjeron se rishikimi i mënyrës sesi funksionojnë institucionet dhe forcimi i përfaqësimit politik janë hapa thelbësorë për të rikthyer besimin në demokraci dhe për të frenuar përhapjen e populizmit në të ardhmen.

Figura 19 tregon shpërndarjen e përgjigjeve të pjesëmarrësve me nivele të ndryshme arsimimi në lidhje me deklaratat për udhëheqjen politike.

Figura 19. *Impakti i nivelit të edukimit në qasjen/zgjedhjen e deklaratave të liderit politik*



Burimi: Të dhënat e autorit

Për të analizuar më mirë të dhënat e marra, u përdor regresioni logjistik me kategori shumëfishe. Për një regresion logjistik me kategori kkk dhe një variabël të pavarur (arsimi), probabiliteti që një përgjigjës të zgjedhë kategorinë e j-j-të (pyetja) mund të shprehet me formulën:

$$P(Y = j) = \frac{\exp(\beta_{0j} + \beta_{1j} \times Education)}{1 + \sum_{k=1}^{K-1} \exp(\beta_{0k} + \beta_{1k} \times Education)}$$

ku: $P(Y=j)$ — probabiliteti i zgjedhjes së kategorisë j , β_{0j} — ndërprerësi për kategorinë j , β_{1j} — koeficienti për variablën "arsimi" për kategorinë j , $\exp$ — funksioni eksponencial, β_{0k} — ndërprerësi për kategorinë k , β_{1k} — koeficienti për kategorinë k .

Rezultatet e regresionit logjik multikategorik për të vlerësuar prirjen ndaj retorikës populiste tregojnë një ndikim të rëndësishëm të nivelit të arsimimit në probabilitetin e mbështetjes së aspekteve të ndryshme të retorikës populiste (Tabela 8).

Table 8. Koeficientët dhe ndërprerësit për secilën deklaratë

Statements	Coefficient	Intercept
Statement 1	-0.462	0.338
Statement 2	-0.413	1.441
Statement 3	0.313	-0.520
Statement 4	0.562	-1.259

Burimi: Të dhënat e autorit

Koeficientët për secilën pyetje tregojnë forcën dhe drejtimin e këtij efekti. Çdo koeficient tregon ndikimin e variablës së pavarur (p.sh., niveli i arsimit) në variablën e varur (zgjedhja e përgjigjes për pyetjen). Deklarata 1 ka një koeficient prej -0.462, dhe Deklarata 2 ka një koeficient prej -0.413. Vlerat negative të koeficientëve tregojnë se probabiliteti i zgjedhjes së këtyre përgjigjeve zvogëlohet me rritjen e nivelit të arsimit. Kjo tregon që respondentët me nivel më të lartë arsimimi janë më pak të prirur të mbështesin ide që justifikojnë shkeljen e normave demokratike për të siguruar një qeveri të fuqishme ose ndryshime të shpejta.

Kundër kësaj, Deklarata 3 ka një koeficient prej 0.313, dhe Pyetja 4 ka një koeficient prej 0.562. Vlerat pozitive të koeficientëve tregojnë se probabiliteti i zgjedhjes së këtyre përgjigjeve rritet me rritjen e nivelit të arsimit. Kjo tregon që respondentët më të arsimuar janë më të prirur të vënë në pikëpyetje premtimet populiste për ndryshime të shpejta dhe preferojnë stabilitetin dhe përkushtimin ndaj normave demokratike. Ky trend tregon një nivel më të lartë të mendimit kritik tek respondentët më të arsimuar, të cilët shohin kompleksitetin e problemeve sociale dhe politike dhe janë të vetëdijshëm për rreziqet e zgjidhjeve të thjeshtuara.

Interceptet në regresionin multinivellar të kategorive tregojnë probabilitetet bazë për secilën kategori përgjigjeje kur variabli i pavarur është zero. Ato tregojnë probabilitetin fillestar të zgjedhjes së secilës mundësi përgjigjeje, pa marrë parasysh ndikimin e variablave të pavarur. Pasi të llogariten koeficientët, secili prej tyre mund të interpretohet si një raport probabilitetesh. Nëse koeficienti për një kategori të caktuar është pozitiv, kjo do të thotë që rritja e vlerës së variablës të pavarur (p.sh., arsimit) rrit probabilitetin për të zgjedhur këtë kategori. Një koeficient negativ, përkundrazi, tregon një zvogëlim të këtij probabiliteti. Intercepti për Deklaratën 2 është më i larti (1.441), duke treguar që pavarësisht nivelit të arsimit, shumë respondente mbështesin idenë e realizimit të vullnetit të

popullit, edhe nëse kjo shkel normat demokratike. Kjo mund të shpjegohet me pritshmëritë e përhapura ndaj politikanëve për veprime të shpejta dhe rezultate, të cilat shpesh janë të pranishme në narrativat populiste. Intercepti për Deklaratën 4 është më i ulëti (-1.259), duke treguar një probabilitet fillestar më të ulët për mbështetje ndaj normave demokratike mes respondentëve me nivele më të ulëta të arsimit. Kjo tregon që përkushtimi ndaj parimeve demokratike është më i përhapur mes qytetarëve më të arsimuar.

Në përgjithësi, rezultatet e regresionit multinivellar të kategorive tregojnë se respondentët me nivele më të larta arsimit janë më kritikë ndaj retorikës populiste dhe preferojnë parimet demokratike ndaj ideve të udhëheqjes së fortë ose zgjidhjeve të shpejta. Krahësuar me ta, respondentët me nivele më të ulëta arsimit tendencojnë të mbështesin qasje më radikale dhe zgjidhje të thjeshta, të cilat mund të lidhen me kapacitetin më të ulët për analizë kritike dhe qasjen e kufizuar në burime të ndryshme informacioni.

Retorika populiste gjithashtu trajton çështje të identitetit kulturor, duke i bërë disa grupe më të ndjeshme përmes identifikimit të tyre me vlerat kombëtare ose kulturore. Në shumë raste, liderët populistë paraqiten si mbrojtës të sovranitetit kombëtar dhe homogjenitetit kulturor kundër kërcënimeve të perceptuara. Intervistat në këtë studim (Shtojca 2) u zhvilluan me qëllim zbërthimin e motiveve dhe faktorëve të brendshëm që përcaktojnë ndjeshmërinë e grupeve të ndryshme sociale ndaj retorikës populiste në Shqipëri. Në veçanti, qëllimi ishte të eksplorohej se si aspektet e ndryshme të diskursit populist – si mbrojtja e identitetit kulturor, sovranitetit kombëtar dhe vlerave tradicionale – ndikojnë në opinionet e njerëzve në varësi të moshës, nivelit të arsimit dhe orientimit të tyre politik.

Një temë e spikatur e intervistave ishte apelimi i retorikës populiste ndaj identitetit kulturor. Tre nga tetë pjesëmarrësit, konkretisht P2, P4 dhe P6, shprehën një ndjenjë krenarie për trashëgiminë e tyre kombëtare dhe kulturore, të cilën e ndjenin shpesh në kundërshtim me forcat e globalizimit dhe ndryshimeve kulturore bashkëkohore. Pjesëmarrësit me këto pikëpamje gjithashtu e shihnin liderët populistë si mbrojtës të këtyre identiteteve tradicionale, të cilat ata ndiheshin të nën përfaqësuar në diskursin politik kryesor. Një temë tjetër që dallohej ishte theksi mbi sovranitetin kombëtar si themel i retorikës populiste. Për katër pjesëmarrës (P2, P4, P6, P7), koncepti i sovranitetit simbolizonte jo vetëm autonominë politike, por edhe qëndresën ndaj ndërhyrjeve të perceptuara nga faktorë të jashtëm, veçanërisht nga entitete të mëdha gjeopolitike ose bashkime ekonomike. Kjo ishte veçanërisht e vërtetë për pjesëmarrësit që ishin skeptikë ndaj integritetit në BE. Këto përgjigje sugjerojnë se tema e sovranitetit, siç e theksojnë liderët populistë, ka rezonancë me ata që janë të kujdesshëm ndaj dorëzimit të kontrollit tek institucionet e jashtme. Pjesëmarrësit që ndanë këtë pikëpamje ishin ata që kishin më pak besim tek institucionet tradicionale demokratike, duke besuar se qeverisja lokale duhet të forcohet për të mbrojtur më mirë interesat kombëtare.

Përveç identitetit kulturor dhe sovranitetit, vlerat tradicionale gjithashtu u përmendën si një apel kryesor në retorikën populiste. Pjesëmarrësi P7, nga grupi i moshave më të vjetra, ndjeu se mënyra e jetesës po kërcënohej nga lëvizja progresive moderne. Kjo reflektonte një ndjenjë më të gjerë mes pjesëmarrësve konservatorë, të cilët e shihnin liderët populistë si politikanët e vetmuar që ishin të gatshëm të mbështesin hapur këto vlera. Ky apel ndaj tradicionalizmit u perceptua si një siguri që normat e tyre kulturore nuk do të nënshtriheshin plotësisht nga idealet e globalizuara ose progresive.

Pjesëmarrësit më të rinj ose ata me nivel më të lartë arsimi, megjithatë, treguan një pikëpamje më skeptike ndaj retorikës populiste. Tre nga pjesëmarrësit (P1, P3, P8) besonin se apelimet ndaj identitetit kulturor dhe vlerave tradicionale shpesh ishin një mjet manipulimi, i destinuar për të fituar mbështetje në vend që të krijonin ndryshime reale. Kjo perspektivë tregon objektivitetin me të cilin disa pjesëmarrës e shohin retorikën populiste, duke e konsideruar atë si një strategji që luan me apel emocional pa mbështetje të substancuar politike. Këto pikëpamje sugjerojnë një hendek brezash në perceptimin e narrativës kulturore të populizmit, me pjesëmarrësit më të rinj që janë më kritikë ndaj autenticitetit të tij.

Përtej këtyre temave qëndron një dyshim i thellë ndaj institucioneve demokratike tek disa pjesëmarrës, që i bënë ata më të prirur për të qenë të hapur ndaj narrativave populiste. Ky dyshim buron nga ndjenja se institucionet tradicionale kanë dështuar të adresojnë mjaftueshëm problemet lokale ose të mbrojnë interesat kulturore. Analiza tregon se retorika populiste rezonon me grupe të ndryshme demografike përmes apelimit ndaj identitetit kulturor, sovranitetit kombëtar dhe vlerave tradicionale. Megjithatë, ndërsa disa pjesëmarrës e shohin populizmin si një mbrojtje të nevojshme të trashëgimisë kombëtare dhe vlerave, të tjerë, veçanërisht të rinjtë, janë më skeptikë ndaj motiveve të tij. Kjo ndarje tematikore tregon kompleksitetin e mbështetjes për populizmin, duke treguar se si ai mund të apelojë për grupe të caktuara shoqërore, ndërkohë që përballet me kritika nga ata që e vënë në dyshim sinjeritetin dhe efektivitetin e tij. Kjo analizë e detajuar ofron një kuptim të thellë të përgjigjeve të ndryshme ndaj narrativave populiste, duke ilustruar mënyrat e ndryshme se si njerëzit lidhen me premtimet e liderëve populistë në varësi të grupeve të tyre shoqërore, politike dhe personale.

Për të përmbledhur këtë seksion, ndjeshmëria ndaj retorikës populiste ndikohet nga një ndërveprim kompleks i faktorëve socio-ekonomikë, psikologjikë dhe kulturorë. Pasiguria ekonomike, alientimi politik dhe ankthi kulturor janë faktorë të rëndësishëm në mbështetje të lëvizjeve populiste, veçanërisht kur ato kombinohen me apeline emocionale dhe narrative anti-elitiste. Zhvillimi i mediave sociale dhe platformave alternative të mediave ka përforcuar më tej arritjen dhe efektivitetin e retorikës populiste, duke krijuar sfida të reja për institucionet demokratike.

Deri më tani, analizat e kryera në këtë disertacion kanë treguar një lidhje midis nivelit të edukimit dhe ndjeshmërisë ndaj retorikës populiste, duke argumentuar se individët me arsim më të

ulët janë më të prirur të bien pre e kësaj retorike dhe, rrjedhimisht, të shfaqin një nivel më të ulët besimi në institucionet demokratike. Megjithatë, ndonëse ky faktor është i rëndësishëm, ai nuk është i vetmi determinant i këtij fenomeni kompleks. Për të pasur një kuptim më të plotë mbi këtë marrëdhënie, është e nevojshme të zgjerojmë analizën duke përfshirë edhe faktorë të tjerë kontekstualë, si perceptimi mbi korrupsionin, statusi ekonomik, orientimi politik, dhe burimet e informacionit, të cilët mund të kenë një ndikim të konsiderueshëm mbi nivelin e besimit në institucionet demokratike.

Ky seksion synon të zgjerojë analizën përtej edukimit dhe të ekzaminojë ndikimin e retorikës populiste mbi besimin në institucionet demokratike në një mënyrë më gjithëpërfshirëse, duke marrë parasysh një gamë më të gjerë variablash që mund të luajnë një rol ndërmjetësues në këtë marrëdhënie. Për të analizuar më tej këtë fenomen, u ndërtua një model i regresionit linear dhe një model i regresionit logjistik, duke përdorur si variabël të varur (dependent variable) besimin në institucionet demokratike, ndërsa si variabla të pavarura (independent variables) u përfshinë faktorët e mëposhtëm:

1. Retorika populiste – Përfaqëson gatishmërinë e individëve për të pranuar narrativa që ndajnë shoqërinë në "popullin e vërtetë" dhe "elitat e korruptuara".
2. Edukimi – Klasifikuar në tre nivele: i ulët, i mesëm dhe i lartë, si faktor që mund të ndihmojë në përpunimin kritik të informacionit politik.
3. Mosha – Një faktor që ndikon në përvojën politike dhe në perceptimet mbi institucionet.
4. Perceptimi mbi korrupsionin – Një vlerësim subjektiv i pjesëmarrësve mbi shkallën e korrupsionit në vend.
5. Statusi ekonomik – Një indikator që lidhet me përjetimin e stabilitetit ekonomik të qytetarëve.
6. Orientimi politik – Kategorizuar në majtas, djathtas, qendër dhe asnjë preferencë, për të vlerësuar nëse bindjet ideologjike ndikojnë në perceptimin mbi institucionet.

Duke përdorur modelin e regresionit linear, u analizua se si këta faktorë ndikojnë në nivelin e besimit ndaj institucioneve demokratike. Për të thelluar më tej këtë analizë, u përdor modeli i regresionit logjistik, duke ndarë besimin në institucione në dy kategori: "i ulët" (1-3) dhe "i lartë" (4-5), për të parë gjasat e një qytetari për të pasur një nivel të lartë besimi në varësi të faktorëve të lartpërmendur.

Modeli linear i regresionit dha rezultatet e mëposhtme:

Variabla	Koeficienti	P-Vlera (Sig.)
Intercept (Konstante)	3.13	0.000*
Retorika populiste	0.1025	0.035
Edukimi	0.0453	0.064*
Mosha	-0.0001	0.981
Perceptimi mbi korrupsionin	-0.2032	0.040*
Statusi ekonomik	0.0862	0.355

Burimi: Të dhënat e autorit

Në këtë model, retorika populiste rezulton një faktor i rëndësishëm në formësimin e besimit në institucionet demokratike ($p = 0.035$), duke sugjeruar se individët që prirën të mbështesin narrativa populiste kanë tendencë të shfaqin më pak besim te institucionet. Kjo mbështet argumentin se populizmi nuk është thjesht një strategji diskursive, por edhe një mekanizëm që ndikon drejtpërdrejt në perceptimin e institucioneve si jo legjitime apo të dështuara. Edukimi gjithashtu del me një efekt të kufizuar, por të rëndësishëm në model ($p = 0.064$), duke treguar se personat me nivel më të lartë arsimimi janë më pak të prirur të bien pre e retorikës populiste dhe, për rrjedhojë, kanë besim më të lartë në institucione.

Në analizën logjistike, ku besimi në institucione u analizua si variabël binare (besim i ulët vs. besim i lartë), u vunë re këto tendenca:

Variabla	Koeficienti	P-Vlera (Sig.)
Intercept (Konstante)	-0.2153	0.672
Retorika Populiste	-0.2746	0.044*
Edukimi	0.1182	0.053*
Mosha	-0.0017	0.778
Perceptimi mbi Korrupsionin	-0.2508	0.032*
Statusi Ekonomik	0.1848	0.165

Burimi: Të dhënat e autorit

Në këtë model, retorika populiste tregohet të jetë një determinant i rëndësishëm për besimin në institucionet demokratike ($p = 0.044$). Individët që mbështesin narrativa populiste kanë më shumë gjasa të kenë besim të ulët në institucionet demokratike. Ndërkohë, edukimi gjithashtu del një faktor mbrojtës ndaj populizmit, pasi individët me arsim më të lartë kanë më pak gjasa të kenë një perceptim

negativ për institucionet demokratike ($p = 0.053$). Kjo nënkupton se arsimi mund të luajë një rol ndërmjetësues në zbutjen e ndikimit të retorikës populiste mbi perceptimin e institucioneve.

Pasojat e retorikës populiste në stabilitetin demokratik

Ky seksion ka për qëllim të identifikojë dhe diskutojë pasojat afatgjata të retorikës populiste për sistemet demokratike, duke u fokusuar në tri fusha kryesore: erozioni i kontrolleve dhe balancave institucionale, ndikimi në polarizimin politik dhe degradimi i diskursit publik.

Liderët populistë, siç është theksuar në kapitujt e mëparshëm, shpesh përdorin retorikë që ka për qëllim dobësimin e pavarësisë dhe legjitimitetit të institucioneve kyçe demokratike, përfshirë gjyqësorin, median dhe trupat zgjedhorë. Duke i paraqitur këto struktura si pjesë të një “establishment të korruptuar”, ata shkatërrojnë besimin publik, duke hapur rrugën për centralizimin e pushtetit ekzekutiv dhe konsolidimin e kontrollit në duar të liderëve populistë. Kjo strategji jo vetëm që dobëson besimin e qytetarëve në proceset demokratike, veçanërisht në procedurat zgjedhore dhe ligjore, por gjithashtu krijon një ambient ku ky besim është më i dobët gjatë periudhave të krizave sociale apo ekonomike. Besimi i ulët i publikut në institucionet demokratike çon në pjesëmarrje më të ulët në zgjedhje dhe angazhim qytetar, duke minuar kështu legjitimitetin e sistemit demokratik si një tërësi.

Megjithatë, është e rëndësishme të pranohet se erozioni i besimit në sistemet demokratike nuk mund të atribuohet vetëm retorikës populiste. Faktorët më të gjerë socio-ekonomikë dhe institucionalë kontribuojnë ndjeshëm në këtë fenomen. Pabarazia ekonomike, për shembull, shpesh ofron një terren të përshtatshëm për narrativat populiste. Në shoqëritë me diferenca të theksuara të pasurisë, liderët populistë e kanalisin shpesh frustrimin publik ndaj institucioneve, duke i paraqitur ato si mbrojtës të interesave të elitës, dhe jo si mekanizma për qeverisje të barabartë. Hulumentimet tregojnë se nivelet më të larta të pabarazisë së të ardhurave korrelojnë me një ulje të besimit në institucionet demokratike, edhe pa retorikën populiste. Po ashtu, pasiviteti institucional luan një rol kyç. Retorika populiste fiton terren në kontekste ku institucionet nuk arrijnë të ofrojnë shërbime publike në mënyrë efektive apo të mbajnë drejtësinë. Skandalet e korrupsionit të zgjatura ose vonesat gjyqësore, për shembull, mund të dëmtojnë besimin publik jo vetëm për shkak të kuadrit populist, por edhe për shkak të mangësive të dukshme të këtyre institucioneve. Në këto raste, retorika populiste vepron si një katalizator, duke amplifikuar pakënaqësitë e mëparshme dhe shfrytëzuar pakënaqësitë socio-ekonomike dhe dështimet institucionale për të konsoliduar pushtetin.

